



Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZGJEDHJET PARLAMENTARE

11 MAJ 2025

Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i ODIHR-it  
Raporti Përfundimtar



Varshavë  
23 tetor 2025

## PASQYRA E LËNDËS

I.	PËRMBLEDHJE.....	2
II.	HYRJE DHE FALËNDERIME .....	6
III.	SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK.....	6
IV.	KUADRI LIGJOR DHE SISTEMI ZGJEDHOR .....	8
V.	ADMINISTRATA ZGJEDHORE.....	9
VI.	PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË NË ZGJEDHJE.....	12
VII.	REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE .....	15
VIII.	REGJISTRIMI I KANDIDATËVE .....	16
IX.	FUSHATA ZGJEDHORE .....	17
X.	FINANCIMI I FUSHATËS .....	22
XI.	MEDIA .....	24
A.	MJEDISI MEDIATIK .....	24
B.	KUADRI LIGJOR.....	25
C.	GJETJET E MONITORIMIT TË MEDIAS AKSES NË INFORMACION TË DETAJUAR .....	26
XII.	ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE ZGJEDHORE .....	27
XIII.	PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE.....	28
XIV.	VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE .....	29
XV.	DITA E ZGJEDHJEVE .....	29
A.	HAPJA, VOTIMI DHE MBYLLJA .....	30
B.	NUMËRIMI DHE REZULTATET .....	31
XVI.	REKOMANDIME .....	34
A.	REKOMANDIMET PRIORITARE .....	34
B.	REKOMANDIME TË TJERA.....	35
	SHTOJCA I: REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË ZGJEDHJEVE.....	38
	SHTOJCA II: LISTA E VËZHguesve NË MISIONIN NDËRKOMBËTAR TË VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE.....	39
	RRETH ODIHR-IT .....	48

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ZGJEDHJET PARLAMENTARE**  
**11 MAJ 2025**

**Raporti Përfundimtar i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të ODIHR-it<sup>1</sup>**

**I. PËRMBLEDHJE**

Pas një ftese për të vëzhguar zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025 dhe në përputhje me mandatin e saj, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) ngriti më 2 prill një Mision të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MVZ). Ky mision, i drejtuar nga Ambasadori Lamberto Zannier, përbëhej nga një ekip bazë prej 12 anëtarësh me seli në Tiranë dhe 26 vëzhgues afatgjatë (VAGJ), të cilët u vendosën më 10 prill në të gjithë vendin. MVZ-ja e ODIHR-it qëndroi në Shqipëri deri më 22 maj për të ndjekur zhvillimet pas zgjedhjeve. Për ditën e zgjedhjeve, Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të ODIHR-it (MVZ) iu bashkuan delegacionet e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së (AP OSBE), Parlamentit Evropian (PE) dhe Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (PACE) për të formuar një Mision Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MNVZ).

Në Deklaratën mbi Gjetjet dhe Përfundimet Paraprake të 12 majit 2025, MNVZ-ja doli në përfundimin se zgjedhjet “ishin konkurruese dhe u administruan në mënyrë profesionale, por u zhvilluan në një mjedis shumë të polarizuar dhe pjesëmarrësit nuk gëzuan kushte të barabarta gare.” Megjithatë, kandidatët në përgjithësi patën mundësi të bënin fushatë lirshëm, ndonëse disa raportuan se u përballën me përpjekje për t'i frikësuar. Administrata zgjedhore e menaxhoi procesin në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente. Votimi nga jashtë vendit, i zbatuar për herë të parë në këto zgjedhje, u administrua mirë, pavarësisht nga vonesat në arritjen e marrëveshjes politike dhe miratimit të tij dhe disa problemeve organizative. Partia në pushtet përfitoi nga përdorimi i gjerë i burimeve administrative gjatë fushatës, duke pasur kështu avantazhin e padrejtë të të qenit në pushtet. Pati gjithashtu një numër të konsiderueshëm pretendimesh për ushtrim presioni ndaj zgjedhësve, veçanërisht ndaj punonjësve të administratës publike. Përveç kësaj, legjislacioni zgjedhor dhe interpretimi i ngushtë i tij nga administrata zgjedhore nuk parandaluan praktikat abuzive. Përqendrimi i pronësisë së mediave që minon pluralizmin e burimeve të informimit, bashkë me autocensurën mes gazetarëve dhe me dominimin e mbulimit mediatik nga dy partitë më të mëdha, ua kufizuan zgjedhësve mundësinë për të bërë një zgjedhje të mirëinformuar. Përdorimi aktiv i rrjeteve sociale online nga garuesit amplifikoi diskursin e ashpër konfrontues, ndërkohë që për identifikimin e përmbajtjeve të dëmshme dhe manipuluese nuk u ngarkua asnjë autoritet. Mekanizmi i ri i koordinimit të institucioneve për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve zgjedhore përbën një zhvillim pozitiv, por nevojitet ndjekja e mëtejshme për të adresuar shqetësimet që ngrihen në mënyrë të vazhdueshme lidhur me shkeljet zgjedhore. Dita e zgjedhjeve ishte përgjithësisht e qetë dhe e organizuar mirë, por u vu re se shpesh nuk u veprua sipas procedurave dhe pati disa incidente si frikësimi dhe influencimi i zgjedhësve, si edhe disa mangësi procedurale dhe mungesë transparence gjatë numërimit të votave.

Kuadri ligjor ofron një bazë të përshtatshme për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike, pavarësisht nevojës për një reformë zgjedhore të plotë me konsultime publike gjithëpërfshirëse. Mangësitë dhe paqartësitë e konstatuara e reduktojnë qartësinë e kuadrit ligjor dhe krijojnë pasiguri në zbatimin e tij, si në germë, ashtu edhe në frymë. Megjithëse disa nga rekomandimet e ODIHR-it janë adresuar, shumica e rekomandimeve të hershme, përfshirë ato që lidhen me përbërjen e komisioneve zgjedhore të niveleve më të ulëta, raportimin e ndërmjetëm mbi financimin e fushatës dhe dispozitat për krijimin e një mjedisi të favorshëm mediatik, duke përfshirë edhe heqjen e përgjegjësive penale për shpifjen, mbeten të paadresuara, duke treguar mungesë vullneti politik për reforma gjithëpërfshirëse.

---

<sup>1</sup> Versioni në anglisht i këtij raporti është i vetmi dokument zyrtar. Versioni në gjuhën shqipe është përkthim jozyrtar.

Parlamenti zgjidhet përmes një sistemi të modifikuar zgjedhor që kombinon listat e mbyllura me ato preferenciale dhe që u fut në zbatim përpara këtyre zgjedhjeve. Disa parti më të vogla argumentuan se ky sistem favorizon dy partitë më të mëdha dhe kufizon ndikimin e votimit preferencial, duke u mundësuar drejtuesve të partive të ruajnë kontroll të konsiderueshëm mbi përfaqësimin në parlament, pjesërisht për shkak të mungesës së demokracisë së brendshme partiake. Disa parti më të vogla i paraqitën këto argumente në Gjykatën Kushtetuese, por Gjykata nuk e konsideroi sistemin si antikushtetues.

Në përgjithësi, përgatitjet teknike për zgjedhjet u zhvilluan në mënyrë efikase, transparente, sipas afateve të përcaktuara dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Megjithatë, disa prej palëve i perceptuan disa anëtarë të KQZ-së si të politizuar. Megjithëse futja e votimit nga jashtë vendit përbënte një zhvillim të rëndësishëm zgjedhor, organizimi i tij rezultoi sfidues, veçanërisht për shkak të kufizimeve kohore të shkaktuara nga miratimi i vonuar nga parlamenti. U vunë re probleme në shpërndarjen e fletëve të votimit, gjë që çoi në vështirësi edhe gjatë procesit të numërimit. Megjithatë, procesi u menaxhua përgjithësisht mirë. Komisionet e niveleve më të ulëta e menaxhuan procesin në mënyrë efikase dhe transparente, pavarësisht ndërprerjeve të shkaktuara nga zëvendësimi i vonuar i anëtarëve të propozuar nga partitë politike, veçanërisht për qendrat e votimit në ditët para zgjedhjeve, për shkak të dyshimeve për frikësim në disa raste. KQZ-ja bëri përpjekje për të përmirësuar aksesueshmërinë në qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuara, por në ditën e zgjedhjeve vëzhguesit raportuan probleme me aksesin në shumë vende.

Votimi elektronik u zhvillua në dy qarqe, kurse identifikimi biometrik u përdor në të gjitha qendrat e votimit. Në përputhje me praktikat e mira zgjedhore, KQZ-ja uli varësinë e saj nga ofruesi i pajisjeve biometrike dhe votimit elektronik, ndërsa përdorimi i teknologjisë u dokumentua dhe u menaxhua në mënyrë transparente dhe të qëndrueshme. Megjithatë, përdorimi i teknologjisë, veçanërisht në lidhje me pajisjet e votimit elektronik, devijoi nga procesi i dokumentuar dhe nga Kodi Zgjedhor. Partitë politike dhe mediat patën akses të plotë për të vëzhguar demonstrimin e funksionalitetit të pajisjeve të identifikimit dhe votimit elektronik, por KQZ-ja nuk publikoi asnjë informacion mbi testet e sigurisë. Bashkëbiseduesit e Misionit të ODIHR-it përgjithësisht shprehën besim te teknologjia, por ngritën disa shqetësime, duke treguar mungesë besimi nga ana e disa aktorëve, përfshirë opozitën.

Në listën e zgjedhësve ishin 3,7 milionë zgjedhës, përfshirë 245,935 të regjistruar jashtë vendit për të votuar me postë. Subjektet zgjedhore kishin të drejtë të kërkonin një kopje të plotë të listës së zgjedhësve, gjë që rriti transparencën e procesit të regjistrimit të zgjedhësve, pavarësisht shqetësimeve që mund të ngrinte lidhur me privatësinë e të dhënave. Zgjedhësve iu dhanë mundësi të mjaftueshme të verifikonin të dhënat e tyre në listën e zgjedhësve si fizikisht, ashtu edhe online. Për votimin nga jashtë vendit, pavarësisht fushatës së gjerë të informimit të zgjedhësve nga KQZ-ja dhe vendimit për të pranuar dokumentet biometrike shqiptare që u kishte kaluar afati i vlefshmërisë, rreth 41,000 aplikime u refuzuan, për shkak të mungesës së një dokumenti të përshtatshëm që vërtetonte qëndrimin e tyre në vendin nga ku aplikonin. Në përgjithësi, procesi i regjistrimit të zgjedhësve ishte transparent, listat e zgjedhësve u konsideruan gjithëpërfshirëse dhe përgjithësisht të sakta, dhe zgjerimi i të drejtës së votës duke u dhënë mundësi zgjedhësve jashtë vendit për të votuar shënoi një hap drejt një pjesëmarrjeje më të gjerë në zgjedhje.

KQZ-ja regjistroi tetë parti dhe tre koalicione dhe miratoi gjithsej 2,046 kandidatë në një proces gjithëpërfshirës. Gjatë verifikimit të kandidatëve u refuzuan gjashtëmbëdhjetë kandidatura për shkak të rekordeve kriminale, asnjë prej të cilave nuk u kontestua, dhe partitë patën mundësinë t'i zëvendësonin. Detyrimi për subjektet zgjedhore që të dorëzonin lista të plota kandidatësh, si për listat e hapura ashtu edhe për listat e mbyllura, dhe për të gjitha zonat zgjedhore në vend, ndikoi në aftësinë e partive më të vogla për të garuar.

Në përgjithësi, fushata ishte e qetë, por pavarësisht nga kjo, u karakterizua nga një diskurs konfrontues dhe polarizues, veçanërisht online dhe sidomos mes dy partive politike kryesore dhe drejtuesve të tyre. Zgjedhësit patën mundësinë të zgjidhnin mes alternativave politike dhe kandidatët, në përgjithësi, gëzuan liri në zhvillimin e fushatës, por mundësitë e garimit nuk ishin të barabarta. Partia në pushtet përfitoi nga përdorimi i gjerë i burimeve shtetërore dhe kapaciteteve institucionale, duke e bërë të paqartë vijën ndarëse mes shtetit dhe partisë. Pati pretendime për presion ndaj nëpunësve të administratës publike, raste intimidimi të mbështetësve të opozitës, si dhe përdorim të rrjeteve të patronazhimit, çka bie ndesh me standardet ndërkombëtare. Çështje të tjera shqetësuese përfshijnë raportimet për shitblerje votash, tentativat për të ndikuar në mënyra të papërshtatshme tek zgjedhësit e marxhinalizuar, si dhe pretendime për ndikim të elementëve kriminalë në disa zona të vendit.

Zhvillimi i fushatës në rrjetet sociale nuk ishte i rregulluar me ligj dhe nuk u caktua asnjë autoritet për monitorimin e saj. Pavarësisht se shumica e partive politike nënshkruan një Kod Etike për Fushatat Dixhitale, disa kandidatë shpërndanë përmbajtje përçarëse ose manipuluese, ndërkohë që disa llogari palësh të treta raportohet se përdorën një sjellje të koordinuar joautentike në platformat online për të amplifikuar sulmet ndaj opozitës. Kandidatët përdorën në mënyrë aktive rrjetet *Facebook* dhe *Instagram*. Ndalimi nga qeveria i platformës *TikTok* që prej 6 marsit 2025 kufizoi mundësitë e disa kandidatëve për fushatë. Megjithëse KQZ-ja identifikoi shkelje në disa postime të institucioneve publike, ajo i ndërpreu hetimet në një numër të vogël rastesh dhe përpjekjet e saj monitoruese mbetën përgjithësisht të kufizuara sa i përket fushës së mbulimit dhe efikasitetit.

Pjesëmarrja e grave në politikë është rritur vitet e fundit, e megjithatë ecja e tyre përpara vazhdon të pengohet nga barrierat e rrënjësura strukturore, sidomos nga niveli i ulët i demokracisë së brendshme dhe mundësitë e kufizuara për financim. Gjithsej, 38.5 për qind e kandidatëve të regjistruar ishin gra, duke përbushur kuotën prej 30 për qind, gjë që tregon nevojën për një vullnet më të madh politik për promovimin e pjesëmarrjes së grave. Numri i grave të zgjedhura në parlamentin e ri ishte i njëjtë me atë të parlamentit të mëparshëm, ku 36 për qind e anëtarëve të zgjedhur janë gra. Tre nga dymbëdhjetë anëtarët e KQZ-së dhe 31 për qind e anëtarëve të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) ishin gra, me një numër të vogël në role drejtuese.

Rekomandimet kyçe të ODIHR-it mbi financimin e fushatës vazhdojnë të mbeten të pazbatuara dhe mangësitë në kuadrin rregullator ndikuan në transparencën e financimit të fushatës dhe në barazinë e mundësive për partitë dhe kandidatët. Mungesa e rregullimit specifik për huatë, fushatat online dhe shpenzimet e palëve të treta, si dhe paqartësitë lidhur me përjashtimin e shpenzimeve të kandidatëve nga kufiri i shpenzimeve të partisë, lejojnë anashkalimin e rregullave. Megjithëse kërkohet me ligj, asnjë prej kandidatëve nuk bëri publike të dhëna lidhur me donacione apo hua dhe KQZ-ja nuk mund të ndërmerre ndonjë veprim për shkak se nuk ka instrumente ligjore për të siguruar zbatueshmërinë e dispozitave ligjore përkatëse. Mungesa e raportimit të ndërmjetëm dhe shqetësimet lidhur me efikasitetin e auditimit e ulën edhe më shumë transparencën dhe llogaridhënien në lidhje me financimin e fushatës.

Klima mediatike vazhdoi të ishte tejet e kufizuar, ku pavarësia, shumëllojshmëria dhe integriteti i përmbajtjes së lajmeve u dëmtua nga financimi jotransparent, përqendrimi i pronësisë së medias, ndërhyrjet në autonominë editoriale dhe ndikimet politike. Pati mungesë të raportimit të pavarur, gjë që cenon rolin mbikëqyrës të medias dhe mungesë të gazetarisë kritike dhe informacioneve solide. Shumica e organeve mediatike perceptohen si mbështetëse të partisë në pushtet. Megjithëse Kushtetuta mbron lirinë e fjalës, shpifja vazhdon të përbëjë vepër penale dhe gazetarët vazhdojnë të përballen me çështje gjyqësore për shpifje. Procedurat e emërimit, si për transmetuesin publik, ashtu edhe për rregullatorin e mediave audiovizuale nuk garantojnë pavarësi *de facto*. Kodi Zgjedhor nuk parashikon mbulim të barabartë të fushatës në edicionet informative për partitë joparlamentare. Në televizionet e monitoruara nga Misioni i ODIHR-it, edicionet informative u dominuan nga Partia Socialiste (PS) dhe

Partia Demokratike (PD). Mbulimi mediatik që nuk i atribuohet qartazi një subjekti zgjedhor ishte mbizotërues, por asnjë masë nuk u mor për adresimin e tij.

Komisioni i Ankesave dhe Sanksioneve (KAS) i trajtoi çështjet në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse. Megjithatë, KAS-i zbatoi një interpretim të ngushtë të rregullave lidhur me përdorimin e burimeve shtetërore, duke bërë që praktika të tilla të kalonin shpesh pa u bërë objekt sanksionesh. Kriteret e ngushta statutores lidhur me kush e ka legjitimitetin për t'u ankuar për një vendim e kufizon mundësinë për zgjidhje ligjore efikase. Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) luajti rol pozitiv në hetimin e korrupsionit zgjedhor dhe mekanizmi i ri i koordinimit midis SPAK-ut, KQZ-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme u pa si një mekanizëm që mund të ketë pasur një efekt parandalues. Megjithatë, disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it ngritën pikëpyetje lidhur me efikasitetin e përpjekjeve kundër lidhjeve të krimit të organizuar me politikën.

Kuadri ligjor parashikon të drejta të plota për pjesëmarrjen në politikë të pakicave kombëtare dhe bërja e fushatës prej tyre në gjuhën e vet lejohet me ligj. Sipas disa partive politike të pakicave, detyrimi ligjor për të dalë me kandidatë në të gjitha zonat zgjedhore që pengesë për partitë më të vogla. KQZ-ja prodhoi materiale zgjedhore dhe materiale për edukimin e zgjedhësve në gjuhët e pakicave kombëtare, por këto ishin të kufizuara dhe nga vëzhgimi nuk u duk se u shpërndanë gjerësisht.

Sipas Kodit Zgjedhor, vëzhguesit e zgjedhjeve kanë të drejtë ta ndjekin procesin në të gjitha nivelet dhe të drejtën për të caktuar vëzhgues e kanë edhe subjektet zgjedhore. Megjithatë, mungesa e financimit për organizatat vendase të shoqërisë civile, veçanërisht nga donatorët ndërkombëtarë, e kufizoi mundësinë e tyre për të ndërmarrë një vëzhgim gjithëpërfshirës të këtyre zgjedhjeve, duke ulur nivelin e mbikëqyrjes së këtij procesi zgjedhor.

Dita e zgjedhjeve ishte e qetë në shumicën e zonave dhe transparente, por me mosrespektim të procedurave në shumë qendra votimi. Megjithëse procesi i votimit u vlerësua përgjithësisht pozitivisht në 95 për qind të vëzhgimeve, pati një numër të lartë vlerësimesh negative, kryesisht për shkak të mangësive procedurale dhe një niveli presioni mbi votuesit. Parregullsitë serioze që u vërejtën përfshinin një numër të konsiderueshëm incidentesh frikësimi dhe ndërhyrjesh tek vëzhguesit dhe përfaqësuesit e partive në proces, ndikim tek zgjedhësit dhe pretendime për shitblerje votash. Përveç kësaj, fshehtësia e votës u komprometua shpesh për shkak të mënyrës së organizimit të qendrave të votimit, mbipopullimit dhe ndërhyrjeve. Më shumë se gjysma e qendrave të votimit të vëzhguara nuk ishin të përshtatshme si duhet për votim në mënyrë të pavarur nga personat me aftësi të kufizuara. Votimi elektronik në përgjithësi u zhvillua pa pengesa, megjithëse shumë zgjedhës dukeshin të pafamiljarizuar me procesin dhe disa zyrtarë zgjedhorë nuk ishin të qartë për rolet e tyre.

Numërimi vazhdoi në mënyrë të rregullt në shumë vende, megjithëse u vunë re disa mangësi procedurale siç ishte një atmosferë kaotike në disa prej qendrave të numërimit. Prosesi i numërimit pësoi vonesa në disa vende për shkak të mbërritjes me vonesë të ekipeve të numërimit ose ndryshimeve në minutën e fundit të anëtarëve të grupeve të numërimit të emëruar nga partitë politike. Pati gjithashtu vonesa në përfundimin e numërimit të fletëve të votimit të votuesve jashtë vendit për shkak të mosmarrëveshjeve lidhur me fletët e votimit nga Greqia. Transmetimi elektronik i parashikuar i rezultateve nga qendrat e votimit elektronik u anulua, dhe në vend të tij u krye transmetimi manual në nivel qarku. Pas një sërë ankesash ndaj rezultateve, KQZ-ja ndërmori disa rinumërimë.

Ky raport ofron rekomandime për të mbështetur përpjekjet për forcimin e mëtejshëm të integritetit të zgjedhjeve në Shqipëri dhe për t'i afruar ato më shumë me angazhimet e OSBE-së dhe me detyrimet e tjera ndërkombëtare dhe standardet për zgjedhje demokratike. Rekomandimet prioritare përfshijnë: ndërmarrjen e një reforme gjithëpërfshirëse të kuadrit ligjor zgjedhor përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe konsultativ; sigurimin e qëndrueshmërisë së administratës zgjedhore duke depolitizuar procedurat

e emërimit për administratën zgjedhore të niveleve më të ulëta; rritjen e ndërgjegjësimit të votuesve mbi procedurat e votimit elektronik; sigurimin e kushteve të barabarta të garës përmes parandalimit të keqpërdorimit të funksionit dhe burimeve shtetërore; si dhe përcaktimin e qartë të veprimtarive parazgjedhore që përbëjnë shpenzime fushate. ODIHR-i mbetet i gatshëm të ndihmojë autoritetet në adresimin e rekomandimeve të përfshira në këtë raport dhe në raporte të mëparshme.

## II. HYRJE DHE FALËNDERIME

Pas një ftese për të vëzhguar zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025 dhe në përputhje me mandatin e saj, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) ngriti një Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) më 2 prill. Ky mision, i drejtuar nga Ambasadori Lamberto Zannier, përbëhej nga një ekip bazë prej 12 anëtarësh me seli në Tiranë dhe 26 vëzhgues afatgjatë (VAGJ), të cilët u vendosën më 10 prill në të gjithë vendin. MVZ-ja e ODIHR-it qëndroi në Shqipëri deri më 22 maj për të ndjekur zhvillimet paszgjedhore.

Në ditën e zgjedhjeve, MVZ-së së ODIHR-it iu bashkuan delegacione nga Asambleja Parlamentare e OSBE-së (AP e OSBE-së), Parlamenti Evropian (PE) dhe Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (PACE) për të formuar një Mision Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MNVZ). Farah Karimi (deputete) u emërua nga Kryesuesi i Radhës i OSBE-së si Koordinator e Posaçme dhe Udhëheqëse e Misionit të Vëzhguesve Afatshkurtër të OSBE-së. Björn Söder (deputet) ishte shefi i delegacionit të AP-së së OSBE-së. Simone Billi (deputet) udhëhoqi delegacionin e PACE-s, kurse Michael Gahler (deputet i PE-së) ishte shefi i delegacionit të PE-së. Secila nga institucionet e përfshira në këtë MNVZ ka miratuar Deklaratën e Parimeve të Vëzhgimit Ndërkombëtar të Zgjedhjeve të vitit 2005. Në ditën e zgjedhjeve, MNVZ-ja përbëhej nga gjithsej 318 vëzhgues nga 47 vende, përfshirë 188 vëzhgues të dërguar nga ODIHR-i, një delegacion prej 96 anëtarësh nga AP e OSBE-së, një delegacion prej 22 anëtarësh nga PACE dhe një delegacion prej 12 anëtarësh nga PE-ja.

MVZ-ja e ODIHR-it vlerësoi përputhshmërinë e procesit zgjedhor me angazhimet e OSBE-së, detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe me legjislacionin vendas. Ky raport përfundimtar vjen pas Deklaratës mbi Gjetjet dhe Përfundimet Paraprake, e cila u publikua në një konferencë për shtyp në Tiranë më 12 maj.<sup>2</sup>

Misioni dëshiron të falënderojë autoritetet e Shqipërisë për ftesën për vëzhgimin e zgjedhjeve, si dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme për ndihmën e dhënë. Misioni i shpreh gjithashtu mirënjohjen institucioneve të tjera shtetërore, gjyqësorit, partive politike, mediave, organizatave të shoqërisë civile, përfaqësuesve të komunitetit ndërkombëtar dhe bashkëbiseduesve të tjerë për bashkëpunimin.

## III. SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK

Shqipëria është republikë parlamentare, ku kompetencat legjislative i ushtron parlamenti me 140 anëtarë të zgjedhur për mandate katërvjeçare. Qeveria drejtohet nga kryeministri dhe ka kompetenca të gjera ekzekutive. Presidenti është kreu i shtetit dhe zgjidhet nga parlamenti për një mandat pesëvjeçar. Më 5 dhjetor 2024, Presidenti Bajram Begaj shpalli zgjedhjet parlamentare për datën 11 maj.

Zgjedhjet parlamentare u mbajtën në një mjedis politik tejet të polarizuar. Procesi i anëtarësimit në BE zuri një vend të rëndësishëm në diskursin politik, ku Partia Socialiste (PS) në pushtet e zhvilloi fushatën

<sup>2</sup> Shihni [raportet e mëparshme të ODIHR-it lidhur me zgjedhjet në Shqipëri](#).

mbi objektivin e anëtarësimit në vitin 2030 dhe theksoi arritjet në procesin e negociatave. Partitë e opozitës kritikuan përdorimin e retorikës së integritetit në BE si një mënyrë për të shmangur vëmendjen nga çështjet e brendshme, si niveli i jetesës, korrupsioni dhe dobësimi i demokracisë. Futja për herë të parë e votimit nga jashtë vendit (VJV) në këto zgjedhje u vlerësua gjerësisht si një arritje e rëndësishme.

Skena politike dominohet nga PS-ja, e udhëhequr nga Kryeministri Edi Rama, dhe nga partia kryesore e opozitës, Partia Demokratike (PD), e udhëhequr nga Sali Berisha. PS-ja ka fituar tre zgjedhje të njëpasnjëshme parlamentare që nga viti 2013 dhe e ka konsoliduar më tej pushtetin në zgjedhjet vendore të vitit 2023.<sup>3</sup> Përçarjet e brendshme të PD-së çuan në një mosmarrëveshje ligjore mbi përfaqësimin zyrtar të partisë, e cila u zgjidh në qershor 2024. Disa fraksione u shkëputën nga PD-ja dhe në vitin 2024 u formuan tre parti të reja të dala prej saj.<sup>4</sup>

Në tetor 2024, ish-presidenti Ilir Meta, Kryetar i Partisë së Lirisë (PL), u arrestua nën akuzat për korrupsion. Muajin pasues, masa e arrestit shtëpiak ndaj Sali Berishës – e vendosur që nga dhjetori 2023 – u shfuqizua, megjithëse ai është ende në pritje të gjyqimit për akuzat për korrupsion.<sup>5</sup> Disa protesta të udhëhequra nga PD-ja u zhvilluan në fund të vitit 2024 dhe në fillim të vitit 2025, të nxitura nga shqetësimet për dobësimin e perceptuar të institucioneve demokratike, akuzat për korrupsion qeveritar dhe keqpërdorim të burimeve shtetërore. Përveç kësaj, PD-ja kërkoi krijimin e një qeverie teknike për të mbikëqyrur zgjedhjet parlamentare. Protestat ishin gjithashtu një reagim ndaj disa arrestimeve dhe hetimeve të profilit të lartë që lidhen me opozitën, të cilat disa i konsideruan si të motivuara politikisht. Në shkurt, u arrestua edhe Erion Veliaj, Kryetari i Bashkisë së Tiranës dhe një figurë e spikatur e PS-së, nën akuzat për korrupsion.

Shqipëria ka një kuadër të konsiderueshëm ligjor për të mbështetur pjesëmarrjen e grave në jetën politike, dhe janë miratuar disa ligje të reja që përfshijnë një dimension gjinor.<sup>6</sup> Pjesëmarrja e grave në politikë dhe në vendimmarrje është rritur vitet e fundit. Në parlamentin paraardhës, gratë mbanin 50 nga 140 vendet gjithsej (36 për qind), si dhe gjysmën e posteve ministrore. Megjithatë, stereotipet gjinore të vazhdueshme dhe mungesa e mekanizmave të brendshëm partiakë për të mbështetur pjesëmarrjen e grave në procesin politik vazhdojnë të veprojnë si pengesë për avancimin e tyre. Në parlamentin e ri, numri i grave të zgjedhura ishte sërish 50.

<sup>3</sup> Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021, PS-ja fitoi 74 vende; Aleanca e udhëhequr nga Partia Demokratike (PD) “Aleanca për Ndryshim” mori 59 vende; Lëvizja Socialiste për Integritet 4 vende; dhe Partia Socialdemokrate (PSD) 3 vende. Në zgjedhjet vendore të vitit 2023, PS-ja fitoi 52 gara për kryetar bashkie, Koalicioni “Bashkë Fitojmë” i udhëhequr nga PD-ja 7, dhe Partia e Minoritetit Etnik Grek për të Ardhmen 1.

<sup>4</sup> Tre parti u krijuan si ndarje nga PD-ja: Koalicioni Euroatlantik, i formuar nga ish-kryetari i PD-së, Lulzim Basha; Partia Mundësia, e udhëhequr nga Agron Shehaj; dhe partia Djathtas 1912 – nga Enkelejd Alibeaj.

<sup>5</sup> Në vitin 2023, prokurorët e posaçëm kundër korrupsionit (SPAK) akuzuan Sali Berishën për korrupsion të lidhur me periudhën e tij si kryeministër (2005–2013).

<sup>6</sup> Duke përfshirë Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Ligjin për Masat kundër Dhunës në Marrëdhëniet Familjare; Ligjin për Shërbimet e Kujdesit Social në Republikën e Shqipërisë; Kodin e Punës; Ligjin për Ndhimën Sociale në Republikën e Shqipërisë; dhe Ligjin për Nxitjen e Punësimit. Në vitin 2024, qeveria nisi konsultimet për rishikimin e Ligjit për Barazinë Gjinore të vitit 2008.

#### IV. KUADRI LIGJOR DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Zgjedhjet parlamentare rregullohen kryesisht nga Kushtetuta e vitit 1998 dhe Kodi Zgjedhor i vitit 2008, të plotësuar nga një sërë aktesh nënligjore të nxjerra nga KQZ-ja.<sup>7</sup> Shqipëria është palë në instrumentet kryesore ndërkombëtare ligjore që lidhen me zgjedhjet demokratike.<sup>8</sup>

Kuadri ligjor ofron një bazë të përshtatshme për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike, por një sërë mangësish dhe paqartësish minojnë qartësinë juridike dhe krijojnë pasiguri në zbatimin e tij.<sup>9</sup> Kodi Zgjedhor u ndryshua ndjeshëm në korrik 2024 dhe shkurt 2025, duke futur ndryshime në sistemin zgjedhor, rregullat e financimit të fushatës dhe për herë të parë – votimin jashtë vendit (VJV), siç kërkohet nga një vendim i Gjykatës Kushtetuese.<sup>10</sup> Përveç kësaj, dispozitat ligjore të shpallura antikushtetuese në vitin 2021 u shfuqizuan më pas.<sup>11</sup> Kështu, vetëm pak ditë para zgjedhjeve, sistemi zgjedhor u ndryshua pas një marrëveshjeje PS-PD, pa një proces gjithëpërfshirës konsultimi publik, në kundërshtim me praktikën e mira ndërkombëtare.<sup>12</sup>

U adresuan disa rekomandime të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias, duke përfshirë ato për rishikimin e pragut kombëtar për kandidatët e pavarur dhe heqjen e mundësisë që drejtuesit e partive politike të kandidojnë në më shumë se një zonë zgjedhore. Megjithatë, shumë rekomandime të hershme mbeten të paadresuara, përfshirë ato që lidhen me përbërjen e komisioneve zgjedhore të niveleve më të ulëta, të drejtat zgjedhore të personave me aftësi të kufizuara intelektuale ose psikosociale, përgjegjësinë penale për shpifjen, mbulimin e pavarur mediatik gjatë fushatave zgjedhore, raportimin e ndërmjetëm mbi financimin e fushatës dhe zgjerimin e rregullave të financimit të fushatës për të përfshirë edhe palët e treta. Kjo ngre shqetësime lidhur me mungesën e vazhdueshme të vullnetit politik për të adresuar mangësitë e hershme në kuadrin ligjor zgjedhor dhe nënvizon nevojën për një reformë gjithëpërfshirëse përmes një procesi konsultues dhe gjithëpërfshirës.

<sup>7</sup> Ligjet e tjera relevante përfshijnë Ligjin për Partitë Politike të vitit 2000, Ligjin për Tubimet të vitit 2001, Ligjin për Median Audio-Vizive të vitit 2013, Ligjin për Dekriminalizimin të vitit 2015, Ligjin për Barazinë Gjinore të vitit 2008 dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të vitit 2024.

<sup>8</sup> Duke përfshirë [Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1966 \(ICCPR\)](#), [Konventën Ndërkombëtare të vitit 1965 për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor](#), [Konventën e vitit 1979 për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave \(CEDAW\)](#), [Konventën e OKB-së kundër Korrupsionit të vitit 2003](#), [Konventën e vitit 2006 për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara \(CRPD\)](#), [Konventën Evropiane të vitit 1950 për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore \(ECHR\)](#), [Konventën Kornizë të vitit 1995 për Pakicat Kombëtare](#), si dhe [Konventën e vitit 2004 të OKB-së kundër Korrupsionit \(UNCAC\)](#). Në vitin 2023, Shqipëria nënshkroi [Protokollin e Dytë Shtesë të Konventës për Krimin Kibernetik](#). Shqipëria është anëtare e Komisionit Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) të Këshillit të Evropës dhe e Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO).

<sup>9</sup> Për shembull, nuk është e qartë se cili afat kohor zbatohet për rregulloret që ndalojnë përdorimin e burimeve administrative për qëllime zgjedhore dhe nuk ka dispozita që rregullojnë fushatën online.

<sup>10</sup> Më 9 dhjetor 2022, Gjykata konstatoi se mungesa e legjislacionit që u mundësonte shtetasve shqiptarë me banim jashtë vendit të votonin përbënte shkelje të të drejtave të tyre kushtetuese dhe detyroi parlamentin të miratonte brenda një viti dispozita që lehtësonin votimin nga jashtë vendit.

<sup>11</sup> Gjykata Kushtetuese vendosi në vitin 2021 se kriteret për shpërndarjen e mandateve parlamentare ishin antikushtetuese, konkretisht pragu i kërkuar për riorganizimin e kandidatëve në listën preferenciale dhe pragu kombëtar prej një për qind i përdorur për kandidatët e pavarur.

<sup>12</sup> Neni II.2.b i [Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias të vitit 2002](#) rekomandon që “Elementet themelore të ligjit zgjedhor, veçanërisht vetë sistemi zgjedhor, përbërja e komisioneve zgjedhore dhe ndarja e kufijve të zonave zgjedhore, nuk duhet t’i nënshtrohen ndryshimeve më pak se një vit para zgjedhjeve, ose duhet të jenë të sanksionuara në kushtetutë ose në një nivel më të lartë se ligji i zakonshëm.” Paragrafi 25 i [Udhëzimeve të ODIHR-it për Hartimin Demokratik të Ligjeve të vitit 2023](#) parashikon se “Të gjitha palët e interesuara dhe aktorët duhet të kenë mundësinë të kenë akses në procesin e hartimit të ligjeve, të informohen për to dhe të jenë në gjendje të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në mënyrë domethënëse.” Shih gjithashtu Seksionin II.A.5.IV të [Listës së Kontrollit](#) për Shtetin e së Drejtës të Komisionit të Venecias, i cili lidhet me aksesin publik në projektligje.

*Për të adresuar rekomandimet e pazbatuara të ODIHR-it, si edhe paqartësitë dhe mospërputhjet e ndryshme, kuadri ligjor zgjedhor duhet të reformohet në mënyrë gjithëpërfshirëse përmes një procesi konsultues dhe gjithëpërfshirës, që përpara zgjedhjeve të ardhshme, në përputhje me standardet dhe praktikën e mira ndërkombëtare.*

Parlamenti zgjidhet përmes një sistemi proporcional nga dymbëdhjetë zona zgjedhore shumë-emërore që korrespondojnë me qarqet administrative. Shpërndarja e mandateve për çdo qark bazohet në numrin e qytetarëve, me qëllim garantimin e barazisë së votës. Devijime të vogla vazhdon të ketë, pavarësisht detyrimit ligjor dhe përpjekjeve për ta përafëruar sa më shumë numrin e zgjedhësve të nevojshëm për të zgjedhur një kandidat në të gjitha qarqet.<sup>13</sup> Sipas sistemit të ri zgjedhor, çdo parti ose koalicion paraqet një listë të mbyllur dhe një listë preferenciale për çdo qark dhe për të gjitha qarqet.<sup>14</sup> Çdo listë e mbyllur duhet të përmbajë një numër kandidatësh të barabartë me një të tretën e numrit të mandateve në qark (të rrumbullakosur në numrin më të afërt), ndërsa lista preferenciale duhet të përmbajë saktësisht aq kandidatë sa ka mandate në qark. Kuota gjinore parashikon që një në çdo tre kandidatë si në listat e mbyllura ashtu edhe në ato preferenciale t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar. Kuota gjinore duhet të respektohet edhe në shpërndarjen përfundimtare të mandateve në listën preferenciale.

Një parti ose koalicion duhet të kalojë pragun kombëtar prej një për qind për t'u kualifikuar për shpërndarjen e mandateve në cilindo nga qarqet, dhe numri total i mandateve për secilën parti në çdo qark përcaktohet në mënyrë proporcionale me numrin e votave të vlefshme të marra.<sup>15</sup> Për secilën parti, mandatet e fituara në një qark u caktohen fillimisht kandidatëve në listën e mbyllur (derisa ajo të shterohet), dhe çdo mandat i mbetur u shpërndahet kandidatëve nga listat preferenciale, bazuar në numrin e votave preferenciale që ata marrin. Disa parti të vogla e kundërshtuan sistemin e ri në Gjykatën Kushtetuese, duke argumentuar se ai favorizon dy partitë dominuese, minon mundësinë reale që kandidatët e listës së hapur të fitojnë mandat dhe nuk respekton kriteret kushtetuese për votimin preferencial. Megjithatë Gjykata Kushtetuese e vlerësoi sistemin si në përputhje me Kushtetutën, pasi ligji nuk cenon kriterin që lidhet me listat e kandidatëve, ai sërish mund të sjellë kontroll ose ndikim të konsiderueshëm të drejtuesve të partive mbi përfaqësimin parlamentar, pjesërisht për shkak të mungesës së demokracisë së brendshme partiake, pasi shumica e mandateve, në mënyrë të pashmangshme, u caktohen kandidatëve në listat e mbyllura, pavarësisht numrit të votave të marra nga kandidatët në listat e hapura.<sup>16</sup>

## V. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Zgjedhjet u administruan nga KQZ-ja, 93 Komisione të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) dhe 5,225 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV). Numërimi u krye në nivel rajonal nga Grupet e Numërimit të Votave (GNV) në 93 Vende të Numërimit të Votave (VNV), një në secilën zonë, plus një qendër shtesë për numërimin e fletëve të votimit nga jashtë vendit. KQZ-ja përbëhet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Zëvendëskomisioneri, Komisioni Rregullator (Rregullatori)

<sup>13</sup> Aktualisht, Kukësi është i vetmi qark që devijon me më shumë se 10 për qind nga mesatarja kombëtare; megjithatë, për shkak të madhësisë së këtij qarku (me vetëm 3 mandate), transferimi i një mandati tjetër në këtë qark do të sillte një devijim edhe më të madh.

<sup>14</sup> Listat e mbyllura renditen nga partia, ndërsa listat preferenciale janë në rend alfabetik, dhe çdo zgjedhës mund të zgjedhë një kandidat.

<sup>15</sup> Mandatet shpërndahen duke renditur herësit që dalin nga pjesëtimi i votave të çdo subjekti zgjedhor me pjesëtues të njëpasnjëshëm (1, 2, 3, etj.) deri në numrin total të mandateve në qark. Garuesit fitojnë aq mandate sa numri i herësve të tyre që renditen brenda numrit të mandateve të disponueshme. Për kandidatët e pavarur, votat pjesëtohen vetëm me një.

<sup>16</sup> Gjykata e rrëzoi ankesën, duke deklaruar se sistemi ishte në përputhje me nenin 64.3 të Kushtetutës, sipas të cilit "ligji për zgjedhjet garanton që jo më pak se dy të tretat e listës shumë-emërore t'i nënshtrohen votimit preferencial dhe siguron përfaqësimin gjinor."

dhe Komisioni i Ankesave dhe Sanksioneve (KAS).<sup>17</sup> Anëtarët e KQZ-së zgjidhen nga parlamenti me jo më pak se tre të pestat e votave. Vetëm tre nga 12 anëtarët e KQZ-së janë gra.

Në përgjithësi, KQZ-ja i administroi zgjedhjet në mënyrë transparente dhe respektoi afatet ligjore. Seancat e KQZ-së u njoftuan në kohë, qenë të hapura për palët e interesuara, përfshirë partitë politike që morën pjesë rregullisht, dhe u transmetuan drejtpërdrejt. KQZ-ja ishte reaguese ndaj palëve të interesuara, duke bashkëpunuar me organizatat e shoqërisë civile dhe partitë politike dhe duke u shpërndarë atyre projekt-rregulloret për shqyrtim. Në përgjithësi, KQZ-ja veproi në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe gëzoi një nivel të lartë besimi ndër aktorët e saj.

Megjithatë, KQZ-ja u përball me sfida teknike në menaxhimin e përgjithshëm të zgjedhjeve. Disa rregullore u ndryshuan deri një javë para ditës së zgjedhjeve, përfshirë një manual udhëzues mbi procedurat e numërimit të votave dhe përpunimin dhe numërimin e fletëve të votimit të dërguara me postë nga jashtë vendit. Si pasojë, disa informacione kyçe nuk u shpërndanë në kohë te punonjësit e qendrave të votimit, partitë dhe aktorët e tjerë të interesuar.<sup>18</sup> Disa aktorë i perceptuan disa anëtarë të KQZ-së si të politizuar në vendimmarrjen e tyre dhe pati raste kur ndarja e kompetencave ndërmjet Komisionerit dhe Rregullatorit dukej e paqartë.<sup>19</sup>

KZAZ-të ishin përgjegjëse për organizimin e zgjedhjeve në zonat e tyre përkatëse, emërimin e anëtarëve të KQV-ve dhe GNV-ve, si dhe të stafit për nxjerrjen e rezultateve.<sup>20</sup> KZAZ-të dhe zyrtarët zgjedhorë të niveleve më të ulëta emërohen nga partitë politike, pavarësisht rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias për të mundësuar emërimin jopartiak të komisionerëve zgjedhorë.<sup>21</sup> KZAZ-të përbëheshin nga 57 për qind anëtarë me përvojë që kishin shërbyer në zgjedhjet e mëparshme, ndërsa 251 anëtarë shërbyen për herë të parë. KZAZ-të përmbushën kuotën ligjore prej 30 për qind për gjininë e nënpërfaqësuar, ku gratë përbënë 31 për qind të anëtarëve; megjithatë, gratë patën prani të kufizuar në rolet drejtuese, gjë që nënvizoi karakterin minimal të kësaj përmbushjeje.<sup>22</sup>

*Për të siguruar një pjesëmarrje më të madhe të grave, KQZ-ja duhet të garantojë që komisionet zgjedhore të niveleve më të ulëta të jenë të balancuara në aspektin gjinor, duke përfshirë edhe emërimin e grave në pozita drejtuese.*

Në përgjithësi, KZAZ-të vepruan në mënyrë profesionale dhe zhvilluan mbledhje të rregullta publike. Para ditës së zgjedhjeve, KZAZ-të u përballën me disa sfida në finalizimin e përbërjes së KQV-ve në zonat e thella dhe në punësimin e stafit, kryesisht për shkak të propozimeve të pamjaftueshme nga PD-ja, PSD-ja dhe PL-ja.<sup>23</sup> Zëvendësimet e minutës së fundit të anëtarëve të KZAZ-ve nga disa parti politike

<sup>17</sup> Komisioneri ka autoritet të gjerë ekzekutiv dhe përfaqëson KQZ-në. Zëvendëskomisioneri ka një funksion specifik për të mbikëqyrur përdorimin e teknologjisë së ID-së së votuesit. Rregullatori miraton aktet nënligjore, ndërsa KAS-i shqyrton ankesat kundër vendimeve të Komisionerit dhe të KZAZ-ve, vendos për vlefshmërinë e votimit dhe të rezultateve të zgjedhjeve, si dhe mund të vendosë sanksione me kërkesë të Komisionerit.

<sup>18</sup> Seksioni II, paragrafi B, pika 3 e [Deklaratës së Rishikuar Interpretative të Komisionit të Venecias të vitit 2024 mbi Stabilitetin e Legjislacionit Zgjedhor](#) përcakton se “Në fushën zgjedhore, siguria juridike do të thotë që besimi në zgjedhjet demokratike, në përputhje me standardet ndërkombëtare, nuk duhet të cenohet nga ndryshimet e vona në legjislacionin parësor ose dytësor, përfshirë ato nga organet zgjedhore.”

<sup>19</sup> Sipas Rregullatorit, Komisioneri kishte tejkaluar kompetencat e tij në disa fusha kyçe, përfshirë: auditimet e sistemeve IT; procedurat për miratimin e auditimeve vjetore financiare të partive politike; zbatimin e programeve pilot të votimit elektronik; si dhe hartimin e rregulloreve për mbledhjen dhe administrimin e rezultateve paraprake të zgjedhjeve.

<sup>20</sup> Sipas KQZ-së, u ngritën 18 qendra të veçanta votimi, 16 në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe dy në shtëpi kujdesi për të moshuar.

<sup>21</sup> Nga 741 anëtarët e KZAZ-ve: 279 ishin nga PD-ja, 279 nga PS-ja, 93 nga PSD-ja dhe 90 nga PL-ja.

<sup>22</sup> Gratë përbënin rreth 26 për qind të të gjithë kryetarëve, zëvendëskryetarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve.

<sup>23</sup> Në rastet kur partitë nuk mund të propozojnë mjaftueshëm anëtarë për KQV-të, KQZ-ja i emëron ata nga një listë rekrutimi. Më 7 maj, KQZ-ja informoi Misionin e Vëzhgimit të Zgjedhjeve të ODIHR-it se vetëm 80 për qind e KQV-ve ishin formuar plotësisht.

ishin shqetësuese, por nuk ndikuan në përgatitjet e përgjithshme.<sup>24</sup> Partitë politike tërhoqën ose zëvendësuan mbi 231 anëtarë të KZAZ-ve nga 744 gjithsej (31 për qind).<sup>25</sup>

Një ditë para zgjedhjeve, rreth 22 për qind e KQV-ve mbetën të paplota. Në ditën e zgjedhjeve, 20 për qind e KQV-ve përbëheshin nga më pak se 7 anëtarë, siç kërkohet me ligj, por kishin 4 deri në 6 anëtarë. KQZ-ja informoi Misionin e ODIHR-it se rreth 1,828 (35 për qind) e të gjithë anëtarëve të KQV-ve u zëvendësuan; 200 zëvendësime (9 për qind) ndodhën një ditë para ditës së zgjedhjeve.<sup>26</sup> Në shumicën e rasteve, partitë i zëvendësuan anëtarët e tyre sipas dëshirës; megjithatë, PD-ja informoi Misionin e ODIHR-it se disa nga anëtarët e saj u ndryshuan pas disa kërcënimeve që thanë se kishin marrë.<sup>27</sup>

*Për të siguruar stabilitetin e administratës zgjedhore, duhet të shihet mundësia e depolitizimit të procedurës së emërimit të administratës zgjedhore të niveleve më të ulëta dhe kufizimi i zëvendësimeve arbitrare të anëtarëve të komisioneve në momentet e fundit, për të garantuar trajnimin në kohë dhe si duhet për të gjithë anëtarët.*

Për të rritur koordinimin në adresimin e shkeljeve të mundshme në afërsi të qendrave të votimit, KZAZ-të emëruan dy anëtarë të çdo KQV-je si koordinatorë sigurie, një anëtar nga partia më e madhe në parlament dhe një nga partia e dytë më e madhe. Ata monitoruan zonën jashtë qendrave të votimit, përfshirë hyrjet, oborret dhe perimetrin deri në 150 metra, për të identifikuar grumbullime të paautorizuara ose persona që orientonin zgjedhësit.

Çdo GNV përbëhej nga katër anëtarë të emëruar nga partia/koalicioni në pushtet dhe nga opozita kryesore. KZAZ-të u përballën me sfida në emërimin e GNV-ve: gjysma e KZAZ-ve raportuan emërime të vonuara ose të paplota dhe 30 për qind e anëtarëve të turnit të dytë nuk u emëruan. Numërimi u krye në dy faza: fillimisht u numëruan dhe u paketuan fletët e votimit nga të gjitha KQV-të për listat e mbyllura, dhe më pas u numëruan fletët e votimit nga të gjitha KQV-të për mandatet preferenciale.

KQZ-ja trajnoi 36,000 punonjës zgjedhorë përmes një programi trajnimi me metodë kaskadë.<sup>28</sup> Megjithëse trajnerët ishin përgjithësisht të përgatitur, në sesionet e vëzhguara nga Misioni i ODIHR-it u vërejt se nuk kishte një metodologji të standardizuar dhe, në disa raste, materiale të mjaftueshme. Në disa raste, sesionet e trajnimit kishin pjesëmarrje të dobët.

*Për të forcuar kapacitetin dhe profesionalizmin e komisioneve zgjedhore të niveleve më të ulëta, KQZ-ja duhet të hartojë një program trajnimi kaskadë të standardizuar, duke përfshirë manuale dhe fletë informuese të lehta për t'u kuptuar.*

Aspekt pozitiv ishte që KQZ-ja zhvilloi një fushatë të gjerë informimi për të rritur ndërgjegjësimin mbi regjistrimin e zgjedhësve, për të parandaluar krimet zgjedhore si shitblerja e votës, për të qartësuar praktikatat e ndaluara, përfshirë keqpërdorimin e burimeve publike, si dhe për të shpjeguar procedurat e ditës së zgjedhjeve, duke përfshirë shënimin e fletës së votimit dhe përdorimin e pajisjeve të votimit elektronik. Fushata synoi të rinjtë dhe gratë votuese, si edhe personat me aftësi të kufizuara dhe pakicat kombëtare. KQZ-ja përgatiti tetë spote informuese që i transmetoi në rrjetet sociale, televizion dhe radio, dhe përktheu disa informacione zgjedhore në gjuhët e pakicave, duke i pajisur edhe videospotet me titra.

<sup>24</sup> Shumë anëtarë zëvendësues kishin shërbyer në zgjedhjet e mëparshme si anëtarë të KQV-ve ose grupeve të numërimit të votave.

<sup>25</sup> PD-ja pati 81 zëvendësime, PS-ja dhe PSD-ja patën nga 58 zëvendësime secila, kurse PL-ja pati 34 zëvendësime.

<sup>26</sup> Neni II.3.1.f i [Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias të vitit 2002](#) rekomandon që “organet që emërojnë anëtarët e komisioneve zgjedhore nuk duhet të jenë të lira t’i shkarkojnë ata sipas dëshirës”.

<sup>27</sup> Për shembull, PD-ja informoi Misionin e ODIHR-it se 20 anëtarë të stafit të KQV-ve në Njësinë 8 në Tiranë ishin tërhequr për shkak të presionit.

<sup>28</sup> Katër trajnerë kombëtarë dhe 76 trajnerë rajonalë përdorën një kombinim të metodës së lektorimit dhe sesioneve interaktive.

Përveç kësaj, KQZ-ja përdori formate të aksesueshme, si interpretimin në gjuhën e shenjave për spotet televizive, dhe ofroi disa materiale dhe informacione për zgjedhësit në alfabetin *Braille*. U shprehën shqetësime për mungesën e edukimit të mjaftueshëm mbi sistemin e ri zgjedhor dhe procedurat e shënimit të fletës së votimit, gjë që mund të ndikonte në aftësinë e disa zgjedhësve për të votuar saktë dhe në mënyrë të pavarur. Herë pas here, disa informacione zgjedhore nuk ishin të lehta për t'u gjetur nga publiku në faqen e internetit të KQZ-së, për shkak të një përditësimi të vazhdueshëm.

Sipas KQZ-së, ka rreth 26,000 zgjedhës të regjistruar me aftësi të kufizuara. Sipas ligjit, zgjedhësit në vend duhet të votojnë duke qenë të pranishëm fizikisht në qendrat e votimit, pasi nuk ka dispozita për votim në banesë apo forma të tjera të veçanta votimi. Personat me aftësi të kufizuara që nuk mund të votonin në mënyrë të pavarur, mund të kërkonin asistencë nga një anëtar i familjes ose një zgjedhës tjetër brenda qendrës së votimit. Për të përmirësuar aksesueshmërinë në qendrat e votimit, KQZ-ja udhëzoi KZAZ-të të instalonin rampa, të vendosnin tabela informuese dhe të siguronin hyrje pa pengesa, si dhe trajnoi stafin e KZAZ-ve dhe KQV-ve për asistimin e zgjedhësve me aftësi të kufizuara. Pavarësisht këtyre përpjekjeve, në ditën e zgjedhjeve vëzhguesit raportuan se shumë qendra votimi ende nuk kishin akses të mjaftueshëm për personat me aftësi të kufizuara (shih seksionin *Dita e Zgjedhjeve*).

*Kur përcaktojnë vendndodhjen e qendrave të votimit, autoritetet zgjedhore dhe bashkitë duhet të marrin masa proaktive për të siguruar aksesueshmëri në hyrje dhe në brendësi të qendrave të votimit për personat me aftësi të kufizuara.*

Për herë të parë, votimi nga jashtë vendit u realizua përmes votimit me postë, i cili u konsiderua gjerësisht si një zhvillim i rëndësishëm zgjedhor. Pati një kuadër rregullator të përshtatshëm për votimin nga jashtë vendit, megjithëse disa aspekte, si procedurat e numërimit, u miratuan me vonë.<sup>29</sup> Zgjedhësit morën fletët e votimit për zonën zgjedhore të adresës së tyre të fundit të regjistruar në Shqipëri dhe fletët e tyre të plotësuara duhet të mbërrinin në KQZ deri në orën 19:00 të datës 11 maj, për t'u numëruar në Vendin e caktuar të Numërimit të Votave (VNV).<sup>30</sup> Qendra e përpunimit të votimit nga jashtë vendit në Tiranë ishte e aksesueshme për vëzhguesit dhe operacionet e saj transmetoheshin drejtpërdrejt.

## VI. PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË NË ZGJEDHJE

Identifikimi biometrik i zgjedhësve u zbatua në të gjitha qendrat e votimit dhe funksionoi kryesisht siç ishte parashikuar.<sup>31</sup> Kur skanimi i gjurmës së gishtit dështonte, zyrtarët zgjedhorë aplikonin zgjidhjen rezervë fizike. Shumica e zgjedhësve votuan me fletë letre, ndërsa votimi elektronik dhe numërimi elektronik vazhdoi në shkallë të kufizuara.

Kodi Zgjedhor kërkon që pilotimet e teknologjisë të përfshijnë jo më pak se 10 për qind të zgjedhësve. Megjithatë, më 25 prill 2025, në kundërshtim me ligjin, Komisioni Rregullator i KQZ-së autorizoi pilotimin e votimit elektronik në dy zona zgjedhore që përfshinin 1.4 për qind të zgjedhësve të

<sup>29</sup> Ndryshimet në ligjin zgjedhor që lidhen me numërimin dhe vlerësimin e fletëve të votimit të dërguara me postë u miratuan në shkurt 2025, tre muaj para zgjedhjeve. Më pas, KQZ-ja miratoi disa rregullore që lidhen me votimin nga jashtë vendit, me disa vonesa (dy rregullore u miratuan në mars 2025).

<sup>30</sup> Sipas ligjit, fletët e votimit me vulë hyrëse ose me informacion gjurmues që konfirmon mbërritjen në Shqipëri brenda afatit do të numëroheshin. Zgjedhësit e diasporës mund të interesoheshin nëse nuk u mbërrinin fletët e votimit.

<sup>31</sup> Çdo QV ka një pajisje *offline* që përmban listat e zgjedhësve nga të gjitha QV-të. Zgjedhësit identifikohen duke skanuar një dokument identifikimi biometrik, ose të dhënat e pasaportës apo kartës së identitetit krahasohen me të dhënat në pajisje. Printohet një kupon letre me të dhënat dhe fotografinë e zgjedhësit, dhe në vend të firmës skanohet gjurma e gishtit.

regjistruar.<sup>32</sup> Ky ishte rezultat i një bllokimi politik lidhur me këtë çështje dhe një kërkesë nga PD-ja për kufizimin e këtij procesi.<sup>33</sup> Vendimi i vonuar, i marrë vetëm disa javë para ditës së zgjedhjeve, krijoi pasiguri për zonat zgjedhore të prekura gjatë periudhës menjëherë para zgjedhjeve. Si pasojë, kompania ofruese u kontraktua për të mbështetur KQZ-në vetëm pak para zgjedhjeve. Këto zhvillime theksojnë nevojën për një qëndrueshmëri më të madhe institucionale ndaj presionit politik dhe për procedura më uniforme për zbatimin e teknologjive në zgjedhje.

*Nëse në të ardhmen mendohet që votimi elektronik të përdoret më gjerësisht, atëherë përdorimi i teknologjive të votimit duhet të menaxhohet në mënyrë gjithëpërfshirëse, transparente dhe të integruar.*

Çdo qendër votimi me votim elektronik ishte e pajisur me dy pajisje me ekran me prekje, të cilat prodhonin një kupon të printuar për çdo votë. Zgjedhësit mund ta shihnin kuponin e tyre përmes një dritareje të tejdukshme, para se të depozitohej në një kuti votimi të vulosur.<sup>34</sup> Pas mbylljes së QV-ve, çdo pajisje duhej të numëronte votat, të transferonte rezultatet në mënyrë elektronike dhe të printonte një raport numërimi. Një total prej 10 për qind e të gjitha kutive të votimit, përfshirë ato të votimit elektronik, i nënshtrohen rinumërimit manual.

Procesi i mbylljes së pajisjeve të votimit elektronik në QV, përfshirë printimin dhe transmetimin e rezultateve të votimit elektronik, u ndal pas një kërkesë nga PD-ja, bazuar në shqetësimet se rezultatet mund të publikoheshin para kohe. Në vend që të mbylleshin, pajisjet e votimit dhe kutitë e votimit u transportuan në KZAZ, ku numërimi filloi në mëngjesin e 12 majit; megjithatë, rezultatet nuk u transmetuan dhe nuk u publikuan brenda afatit të parashikuar. Ky vendim sinjalizoi mungesën e vazhdueshme të besimit politik tek sistemi, ngriti pyetje lidhur me llogaridhënien dhe procedurat e rregullta dhe minoi besimin tek teknologjia zgjedhore.

*Për të garantuar integritetin dhe për të rritur besimin e publikut, vendimet që lidhen me përdorimin e teknologjisë në zgjedhje duhet t'i përmbahen kuadrit rregullator ekzistues dhe nuk duhet të merren si përgjigje ndaj presionit politik.*

KQZ-ja menaxhoi identifikimin biometrik, pilotimet e votimit elektronik dhe sistemet e ndryshme të informacionit zgjedhor përmes kontraktorëve privatë dhe stafit të KQZ-së, me pak varësi nga shërbimet shtetërore të IT-së.<sup>35</sup> Krahasuar me zgjedhjet e mëparshme dhe në përputhje me praktikën e mira zgjedhore, KQZ-ja qe më pak e varur nga kompania ofruese e pajisjeve, e cila në zgjedhjet e mëparshme konfiguronte pajisjet dhe siguronte mbështetje të plotë teknike. Kërkesat teknike ishin në përputhje me ligjin dhe përdorimi i teknologjisë u dokumentua dhe u menaxhua në mënyrë të qëndrueshme.<sup>36</sup>

<sup>32</sup> Pilotimi i vitit 2025 përfshiu 75 KQV me 51,505 zgjedhës të regjistruar (31 QV me 22,290 zgjedhës të regjistruar në Tiranë dhe 44 QV me 29,215 zgjedhës në Vorë).

<sup>33</sup> Përfaqësuesi i PD-së veçoi dy KZAZ në [seancën e Komisionit Rregullator](#) më 28 prill. Në tetor 2024, gjatë konsultimeve me KQZ-në, [kundërshtimet](#) e tyre theksuan se çështjet nga vitet 2021 dhe 2023 nuk ishin adresuar mjaftueshëm dhe se kishte pak kohë në dispozicion për t'i trajtuar. KQZ-ja [deklaroi](#) në vitin 2024 se PD-ja mbetet skeptike dhe se duhet të bjerë dakord para zgjerimit të votimit elektronik. Në vitin 2023, Kryetari i PD-së e kishte [denoncuar](#) pilotimin si “një manipulim monstruoz, të gatuar digjitalisht.”

<sup>34</sup> Zgjedhësit kishin mundësinë ta linin fletën e votimit bosh dhe mund të votonin edhe një herë (në këtë rast, vota e parë printohet si fletë votimi e pavlefshme). Fletët e votimit në letër ishin të disponueshme si masë rezervë, por nuk u përdorën paralelisht.

<sup>35</sup> KQZ-ja ofron menaxhimin dhe logjistikën e teknologjisë, ofron mbështetje teknike, rekruton dhe trajnon operatorët e pajisjeve dhe menaxhon infrastrukturën e saj.

<sup>36</sup> Partitë politike dhe publiku kanë akses në dokumentet që detajojnë teknologjinë e përdorur, proceset e prokurimit dhe menaxhimit.

Me ligj, zgjedhjet konsiderohen si infrastrukturë kritike informacioni.<sup>37</sup> Kështu, KQZ-ja i është nënshtruar certifikimit për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit.<sup>38</sup> Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike mbështeti KQZ-në me testime shpesh të sigurie, vlerësime teknike dhe rekomandime për përmirësim; në vitin 2025, fokusi i veçantë ishte sigurimi i platformave të regjistrimit për votimin nga jashtë vendit dhe mbrojtja e të dhënave personale të zgjedhësve të diasporës. Megjithatë disa institucione shqiptare kanë qenë në shënjestër të sulmeve kibernetike me motive politike vitet e fundit, bashkëbiseduesit e Misionit të ODIHR-it nuk raportuan shqetësime për ndërhyrje kibernetike të huaja lidhur me zgjedhjet dhe nuk u raportua asnjë incident i sigurisë kibernetike që të kishte ndikuar tek zgjedhjet.

Veprimet në ditën e zgjedhjeve nuk kishin uniformitet në aspektin e strukturimit dhe përdorimit të dokumenteve elektronike të identifikimit dhe të pajisjeve të votimit. Disa pajisje të identifikimit elektronik dhe të votimit elektronik patën defekte, duke shkaktuar ndërprerje të procesit. Procedurat ndryshuan veçanërisht në ditën e zgjedhjeve, ku disa anëtarë të KQV-ve dhe disa operatorë pajisjesh demonstruan mosnjohjen e përgjegjësive të tyre. Megjithatë KQZ-ja veprroi në mënyrë profesionale, ajo pati mungesë stafi dhe u përball me sfida në nivel qarku dhe qendrash votimi lidhur me kapacitetin e operatorëve teknikë.

KQZ-ja organizoi një sërë demonstrimesh teknologjike në rrugë për të rritur ndërgjegjësimin e zgjedhësve mbi votimin elektronik, por ato demonstrime që u vëzhguan nga Misioni i ODIHR-it nuk qenë veçanërisht proaktive.<sup>39</sup> Në ditën e zgjedhjeve, zgjedhësit shpesh nuk mund t'i përdornin pajisjet e votimit elektronik në mënyrë të pavarur dhe kërkonin shpesh asistencë verbale nga operatorët e pajisjeve. Veçanërisht votuesit më të moshuar dhe ata me më pak njohuri teknologjike hasën vështirësi. Mungesa e edukimit proaktiv, me një pikësynim të qartë dhe të përshtatur për zgjedhësit që nuk janë të familjarizuar me pajisjet inteligjente minon parimin e së drejtës së përgjithshme të votës dhe besimin tek procesi, pasi sistemet e votimit nuk janë lehtësisht të kuptueshme dhe të përdorshme nga të gjithë zgjedhësit.<sup>40</sup>

*Përpjekjet për edukimin e zgjedhësve mbi votimin elektronik duhet të intensifikohen për të rritur ndërgjegjësimin e zgjedhësve mbi procedurat dhe për t'u siguruar që të gjithë zgjedhësit të jenë në gjendje të votojnë në mënyrë të pavarur.*

Një kampion i rastësishëm prej tre për qind i pajisjeve të identifikimit elektronik dhe votimit elektronik iu nënshtrua demonstrimeve publike të testimit të përdorshmërisë, në të cilat mund të merrnin pjesë partitë politike, vëzhguesit dhe mediat, duke kontribuar kështu në transparencë. Bashkëbiseduesit e Misionit të ODIHR-it përgjithësisht shprehën besim te teknologjia, por pati disa shqetësime lidhur me mungesën e besimit, kryesisht nga opozita.<sup>41</sup>

Megjithatë Kodi Zgjedhor nuk kërkon auditim ose certifikim të pavarur, KQZ-ja bëri përpjekje për t'u përfruar me standardet ndërkombëtare duke marrë në konsideratë rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it mbi teknologjitë zgjedhore. Përveç kryerjes së testeve të brendshme, një kontraktor i pavarur

<sup>37</sup> [Detyrimet sipas Ligjit për Sigurinë Kibernetike](#) të vitit 2024, i cili i përcakton institucionet e pavarura si [infrastrukturë kritike të informacionit](#), fokusohen në raportimin tek Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.

<sup>38</sup> Certifikimi ISO 27001 bazohet në auditimin e pavarur të kontrolleve, dokumenteve dhe proceseve të sigurisë së informacionit. Nuk përfshin vlerësimin teknik ose testimin.

<sup>39</sup> KQZ-ja zhvilloi demonstrime ndërgjegjësuëse për zgjedhësit për dy javë në pesë vende brenda zonës së votimit elektronik.

<sup>40</sup> Sipas [Rekomandimit CM/Rec\(2017\)5\[1\]](#) të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi standardet për votimit elektronik (Shtojca I), “[n]dërfaqja me zgjedhësin në një sistem të votimit elektronik duhet të jetë e lehtë për t’u kuptuar dhe për t’u përdorur nga të gjithë zgjedhësit.”

<sup>41</sup> Gjatë testimit funksional të pajisjeve të verifikimit të zgjedhësve më 28 prill, aktivisti politik Altin Goxhaj [yuri në dyshim](#) besueshmërinë e tyre.

kreu testimi sigurie të serverëve të KQZ-së, faqes së internetit dhe pajisjeve të identifikimit biometrik dhe votimit elektronik, në përputhje me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it. Megjithatë, transparenca e KQZ-së lidhur me këto testimi sigurie që e kufizuar. Përveç informacionit mbi tenderin publik, KQZ-ja nuk publikoi detaje shtesë rreth testeve të sigurisë. Megjithëse është e kuptueshme që informacionet e ndjeshme të sigurisë nuk mund të bëhen publike, KQZ-ja nuk komunikoi as shtrirjen, metodologjinë apo një përmbledhje të rezultateve të këtyre testeve, gjë që mund të kishte rritur besimin e publikut dhe aktorëve të interesuar.

## VII. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE

Shtetasit shqiptarë që kanë mbushur 18 vjeç në ditën e zgjedhjeve kanë të drejtë të votojnë. Shtetasit të cilëve paaftësia ligjore u është deklaruar me vendim gjykatë nuk mund të votojnë, në kundërshtim me detyrimet ndërkombëtare që ndalojnë diskriminimin bazuar në aftësinë e kufizuar.<sup>42</sup> Shtetasit që vuajnë një dënim me burg për kryerjen e disa veprave penale të caktuara nuk lejohen të votojnë.<sup>43</sup>

*Për të qenë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për të garantuar të drejtën universale të votës dhe trajtimin e barabartë para ligjit, të gjitha kufizimet e të drejtës së votës të bazuara tek aftësia e kufizuar intelektuale ose psikosociale duhet të hiqen, përfshirë ato që bazohen në vlerësime individuale të gjykatës.*

Regjistrimi i zgjedhësve për votimin brenda vendit është pasiv, i bazuar në regjistrin civil. Listat e zgjedhësve nxirren nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile dhe mirëmbahen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila është nën Ministrinë e Brendshme. Në përgjithësi, procesi i regjistrimit të zgjedhësve ishte transparent dhe aktorët zgjedhorë kishin besim në gjithëpërfshirjen dhe saktësinë e përgjithshme të listave të zgjedhësve. Zgjedhësit mbi 100 vjeç hiqen automatikisht nga listat e zgjedhësve dhe duhet të konfirmojnë statusin e tyre për t'u përfshirë, gjë që mund t'u krijojë një barrë të panevojshme këtyre zgjedhësve.<sup>44</sup> Përveç kësaj, zgjedhësit mund të hiqen nga regjistri kombëtar vetëm në rast vdekjeje ose me kërkesë të tyre.

Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të kërkojnë një kopje të plotë të listës së zgjedhësve, gjë që rriti transparencën e procesit të regjistrimit të zgjedhësve, pavarësisht shqetësimeve që mund të ngrinte lidhur me privatësinë e të dhënave.<sup>45</sup> Zgjedhësve u ofrohej mundësi e mjaftueshme për të verifikuar të dhënat e tyre në listën e zgjedhësve, si fizikisht, ashtu edhe online, deri një ditë para ditës së zgjedhjeve.<sup>46</sup> Siç kërkohej me ligj, KQZ-ja emëroi dy auditues për të vlerësuar saktësinë e listave të

<sup>42</sup> Nenet 12 dhe 29 të [Konventës së vitit 2006 për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara](#) (KRPAC) të vitit 2006 kërkojnë nga Shtetet palë “t’u garantojnë personave me aftësi të kufizuara të drejta politike dhe mundësinë për t’i gëzuar ato në mënyrë të barabartë me të tjerët”. Sipas Komitetit të Përgjithshëm nr. 1 të vitit 2014 të Komitetit të OKB-së për KRPAC-un, “aftësia vendimmarrëse e një personi nuk mund të përdoret si justifikim për asnjë përjashtim të personave me aftësi të kufizuara nga ushtrimi i të drejtave të tyre politike, përfshirë të drejtën për të votuar dhe të drejtën për t’u zgjedhur”. Në paragrafin 9.4 të Komunikimit nr. 4/2011 të vitit 2013, Komiteti thekson se: “përjashtimi nga e drejta e votës mbi bazën e një aftësie të supozuar ose faktike psikosociale ose intelektuale, përfshirë edhe kufizimet e vendosura në bazë të një vlerësimi individual, përbën diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar”.

<sup>43</sup> Në përputhje me nenin 45 të Kushtetutës, Ligji për Dekriminalizimin ua mohon të drejtën e votës personave që vuajnë një dënim me burg për kryerjen e veprave penale të parashikuara në mbi 80 nene të Kodit Penal (nga veprat e lidhura me zgjedhjet deri te krimet e rënda).

<sup>44</sup> DPGJC-ja identifikoi 181 zgjedhës të tillë.

<sup>45</sup> Paragrafi 4.1.3 i [Udhëzimeve](#) të Këshillit të Evropës të vitit 2024 për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale parashikon se “Në përputhje me parimin e minimizimit të të dhënave, të dhënat e përpunuara në regjistrat e zgjedhësve dhe listat e zgjedhësve duhet të kufizohen vetëm në ato të nevojshme për regjistrimin dhe verifikimin e zgjedhësve”.

<sup>46</sup> Për çdo korigjim apo përfshirje në listën e zgjedhësve, një zgjedhës duhet të paraqesë kërkesë në gjykatën e rrethit maksimumi 24 orë para ditës së zgjedhjeve, dhe gjykata duhet të vendosë jo më vonë se 6 orë para mbylljes së votimit.

zgjedhësve brenda dhe jashtë vendit. Audituesit shqyrtuan çdo muaj shpërndarjen e zgjedhësve në qendrat e votimit, duke filluar gjashtë muaj para ditës së zgjedhjeve, dhe raportuan se procesi ishte menaxhuar me sukses. KQZ-ja publikoi listat përfundimtare të zgjedhësve më 2 prill me 3,713,761 zgjedhës të regjistruar, duke përfshirë edhe ata me banim jashtë vendit.<sup>47</sup>

Shtetasit me të drejtë vote me leje qëndrimi zyrtare jashtë vendit mund të regjistroheshin për të votuar jashtë vendit. Pas një fushate të gjerë informimi për diasporën, KQZ-ja zhvilloi regjistrimin e zgjedhësve nga 11 janari deri më 4 mars. Zgjedhësit duhej të ngarkonin elektronikisht dokumentet e tyre biometrike shqiptare (të lëshuara pas vitit 2009), lejen e qëndrimit të lëshuar nga autoriteti i vendit pritës, si dhe një dokument që vërtetonte adresën e vendbanimit (p.sh. një faturë të shërbimeve ose një vërtetim nga banka, nëse adresa nuk ishte e vendosur tek leja).<sup>48</sup> Fillimisht, KQZ-ja kërkonte dokumente shqiptare të vlefshme, por e ndryshoi vendimin për të lejuar regjistrimin e atyre me dokumente biometrike të skaduara.<sup>49</sup> Lista përfundimtare e zgjedhësve për votimin nga jashtë vendit u publikua më 11 mars me 245,935 zgjedhës nga 85 vende.<sup>50</sup> Rreth 41,000 aplikime u refuzuan, kryesisht për mungesë të lejeve të qëndrimit ose një dokumenti që vërtetonte adresën e vendbanimit në vendin përkatës të qëndrimit.

Sipas ligjit, shtetasit me të drejtë vote duhet të paraqiteshin për të votuar me një pasaportë biometrike ose kartë identiteti të vlefshme. Megjithatë, sipas Ministrisë së Brendshme, 360,808 shtetas, disa prej të cilëve banojnë në Shqipëri, kanë dokumente identifikimi të skaduara.<sup>51</sup> Më 7 maj, katër ditë para ditës së zgjedhjeve, Këshilli i Ministrave zgjati vlefshmërinë e dokumenteve të skaduara deri më 31 maj, duke u mundësuar votimin mbajtësve të këtyre dokumenteve.

## VIII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Çdo zgjedhës me të drejtë vote ka të drejtë të kandidojë në zgjedhje, përveç atyre që vuajnë një dënim me burg bazuar në një vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale të caktuara. Kjo e drejtë mund të kufizohet edhe për shtetas të dënuar me vendim jo të formës së prerë në juridiksione të caktuara, si edhe për individë që janë objekt i një urdhër-arresti ndërkombëtar ose që janë dëbuar nga disa shtete.<sup>52</sup> Për më tepër, Kushtetuta përcakton kategori zyrtarësh pozitat e të cilëve konsiderohen të papajtueshme me të drejtën për të kandiduar.<sup>53</sup>

<sup>47</sup> Regjistrimi i vitit 2023 nga Instituti i Statistikave (INSTAT) përcaktoi se numri i banorëve të Shqipërisë ishte ulur në 2.4 milionë nga 2.8 milionë në vitin 2011.

<sup>48</sup> Vendbanimi i fundit i zgjedhësit në Shqipëri, mbi bazën e të cilit zgjedhësi caktohet në një njësi zgjedhore, merret nga regjistri kombëtar i popullsisë.

<sup>49</sup> KQZ-ja mori një numër të madh kërkesash nga zgjedhës jashtë vendit lidhur me dokumentet e skaduara biometrike shqiptare, çka e shtyu qeverinë të nxirrte një akt më 5 shkurt për të lejuar përdorimin e dokumenteve të skaduara.

<sup>50</sup> Grupet më të mëdha të zgjedhësve të regjistruar për votim nga jashtë ishin në Itali, me 91,223 (37.1 për qind), dhe në Greqi, 68,386 (27.8 për qind). Përveç kësaj, kishte numër të madh zgjedhësish të regjistruar në Gjermani 25,499 (10.4 për qind), Shtetet e Bashkuara të Amerikës 20,653 (8.4 për qind) dhe Mbretërinë e Bashkuar 17,227 (7 për qind).

<sup>51</sup> Sipas MPB-së, më 11 maj, 262,848 shtetas shqiptarë nuk kishin asnjë dokument identifikimi dhe 550,633 kishin pasaporta të skaduara.

<sup>52</sup> Ligji për Dekriminalizimin i referohet dëbimit nga një shtet anëtar i BE-së, Australia, Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Përveç kësaj, shtetasit e dënuar për disa vepra penale ose të dëbuar, edhe në mungesë të një vendimi përfundimtar gjyqësor, nga një shtet anëtar i BE-së, Australia, Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara, nuk lejohen të kandidojnë, ashtu si edhe ata ndaj të cilëve është lëshuar një urdhër ndërkombëtar kërkimi.

<sup>53</sup> Presidenti i Republikës, gjyqtarët, prokurorët, ushtarakët, punonjësit e policisë, shërbimeve të sigurisë kombëtare, diplomatët, kryebashkiakët, prefektët, kryetarët dhe anëtarët e komisioneve zgjedhore, si edhe funksionarët e lartë të administratës shtetërore të përcaktuar me ligj.

KQZ-ja regjistroi tetë parti politike dhe tre koalicione deri në afatin e 12 marsit.<sup>54</sup> Nga këto, vetëm Partia Aleanca Kombëtare Shqiptare drejtohej nga një grua. Partitë dhe koalicionet ishin të detyruara të paraqisnin dy listash kandidatësh: një listë të mbyllur me rend të përcaktuar paraprakisht dhe një listë të veçantë për votimin preferencial, të renditur alfabetikisht. Kandidatët nuk mund të shfaqeshin në disa zona zgjedhore ose në të dyja llojet e listave njëkohësisht. Në përputhje me një rekomandim të mëhershëm të ODIHR-it, u hoq mundësia që drejtuesit e partive të kandidonin në disa zona zgjedhore. Disa parti më të vogla dhe parti të pakicave informuan Misionin e ODIHR-it se kishin vështirësi në identifikimin e një numri të mjaftueshëm kandidatësh në të gjitha qarqet. Megjithëse mosparaqitja e kandidatëve të mjaftueshëm në ndonjë qark mund të çonte në refuzim të regjistrimit, të gjithë njëmbëdhjetë subjektet zgjedhore përmbushën kërkesat ligjore dhe u regjistruan. Në përgjithësi, bashkëbiseduesit e Misionit të ODIHR-it nuk ngritën shqetësime për procesin e regjistrimit.

KQZ-ja verifikoi kandidatët në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe Ligjin për Dekriminalizimin.<sup>55</sup> Subjektet zgjedhore patën mundësinë të hiqnin dhe të zëvendësonin kandidatët e tyre përpara se KQZ-ja të finalizonte listat e kandidatëve. Gjatë regjistrimit, 16 kandidatë u skualifikuan bazuar në vetëdeklarimet e tyre, dhe partitë e prekura paraqitën kandidatë të rinj.<sup>56</sup> Deri në afatin e 25 marsit, KQZ-ja regjistroi 2,046 kandidatë, prej të cilëve 787 (38.47 për qind) ishin gra.

## IX. FUSHATA ZGJEDHORE

Periudha zyrtare e fushatës nisi më 11 prill dhe vazhdoi deri 24 orë para ditës së zgjedhjeve.<sup>57</sup> Fushata që përgjithësisht jo e bujshme, me fokus në aktivitete të vogla me prani fizike, takime derë më derë dhe në rrjetet sociale. PS-ja dhe PD-ja organizuan aktivitete të mëdha, së bashku me një numër të kufizuar tubimesh nga partitë më të vogla. Posterët elektorale lejoheshin në hapësira publike të përcaktuara; megjithatë, garuesit shpesh nuk i përdorën ato. Disa kryetarë bashkish nuk përcaktuan hapësira të tilla. PS-ja, PD-ja dhe nisma “Shqipëria Bëhet” zhvilluan fushatë të gjerë jashtë vendit, veçanërisht para periudhës zyrtare të fushatës, ndërsa partitë më të vogla u fokusuan kryesisht te fushata në rrjetet sociale për diasporën. PS-ja i paraqiti zgjedhjet si vendimtare për sigurimin e rrugës drejt anëtarësimit në BE dhe theksoi arritjet e mëparshme në zhvillimin infrastrukturor dhe ekonomik. PD-ja premtoi rritje pensionesh, një pagë minimale të jetesës, ulje taksash dhe reformë arsimore. Partitë më të vogla apeluan me premtimet se do të ofronin një alternativë ndaj politikës së dominuar prej dy partish, forcimin e institucioneve demokratike, luftën kundër korrupsionit dhe përmirësimin e standardeve të jetesës, arsimit dhe kujdesit shëndetësor.

<sup>54</sup> Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore” (PD–ASHM), Lëvizja Bashkë, Lëvizja Atdheu, Partia Koalicioni Euroatlantik (KEA), Partia Socialiste e Shqipërisë, Koalicioni Nisma Shqipëria Bëhet – Adriatik Lapaj, Partia Aleanca Kombëtare Shqiptare, Partia Aleanca Demokracia e Re, Koalicioni Djathtas për Zhvillim, Partia Mundësia dhe Partia Socialdemokrate.

<sup>55</sup> Çdo kandidat duhet të paraqesë një formular vetëdeklarimi, ndër dokumentet e tjera mbështetëse për kandidim. Procesi i verifikimit nga KQZ-ja kryhet në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (Zyra e Gjendjes Gjyqësore Penale) dhe Zyrën e Gjendjes Civile. Procedurat rregullohen nga Ligji për Dekriminalizimin, një akt nënligjor i Kuvendit, si dhe nga udhëzimet e Komisionerit.

<sup>56</sup> Gjastëmbëdhjetë kandidatë kishin kryer vepra penale që, sipas legjislacionit, përbënin pengesë ligjore për kandidimin, bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Pesë prej kandidatëve ishin nga Aleanca Demokracia e Re, katër nga Aleanca Kombëtare Shqiptare, dy nga Lëvizja Atdheu dhe Djathtas për Zhvillim secila, dhe nga një kandidat përkatësisht nga Partia Socialdemokrate, Partia Mundësia dhe Partia Demokratike.

<sup>57</sup> Heshtja zgjedhore u respektua përgjithësisht; megjithatë, disa garues, përfshirë z. Berisha, vazhduan të postonin përmbajtje të lidhur me fushatën në llogaritë e tyre në rrjetet sociale, ndërsa z. Rama dha intervista dhe postoi përmbajtje të lidhur me pjesën shqiptare të evenimentit të ciklizmit Giro d’Italia. Më 10 maj, KQZ-ja u bëri thirrje subjekteve zgjedhore që të respektonin heshtjen zgjedhore, përfshirë në rrjetet sociale.

Misioni i ODIHR-it vëzhgoi 88 aktivitete fushate, ndër të cilat, në 69 kishte edhe folëse gra. Gjithsej 67 prej këtyre aktiviteteve ishin të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, por asnjëri nuk ofronte përkthim në gjuhën e shenjave. Toni i fushatës ishte shpesh konfrontues, me sulme personale mes dy partive kryesore dhe drejtuesve të tyre.<sup>58</sup> PS-ja synoi të diskreditonte opozitën, ndërsa PD-ja akuzoi qeverinë për korrupsion, keqmenaxhim dhe lidhje me grupe të krimit të organizuar. Disa garues përdorën gjuhë diskriminuese, përfshirë terma ofendues ndaj personave me aftësi të kufizuara kur u referoheshin rivalëve apo zgjedhësve. Në disa raste, u përdor gjuhë seksiste ndaj kandidatëve gra, burra dhe komunitetit LGBTQI.

Megjithëse garuesit zhvilluan fushatë lirshëm dhe zgjedhësit patën mundësi zgjedhjeje mes alternativave politike, fusha e garës ishte e pabarabartë, me partinë në pushtet që përfitonte nga përdorimi i burimeve administrative dhe ndikimi institucional. Ligji ndalon përdorimin e burimeve shtetërore për fushatë, por i lejon ata që bëjnë fushatë që të kryejnë detyrat e tyre zyrtare gjatë periudhës së fushatës. Pak para fushatës dhe gjatë saj, ministrat dhe kryeministri morën pjesë në aktivitete zyrtare, kryen inspektime objektsh, promovuan dhe inauguruan projekte investimi dhe infrastrukturore, duke kontribuar në avantazhin e partisë në pushtet dhe, në disa raste, duke bërë fushatë haptazi.<sup>59</sup> Përveç kësaj, disa aktivitete madhore gjatë periudhës së fushatës u përdorën për të përmirësuar imazhin publik të partisë në pushtet.<sup>60</sup>

*Për të hequr çdo paqartësi në legjislacion lidhur me fushatën, përdorimi i burimeve administrative për qëllime zgjedhore duhet të ndalohet nga momenti i shpalljes së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve.*

Ligji ndalon propozimin ose miratimin e legjislacionit që jep përfitime për segmente të caktuara të popullsisë brenda katër muajve para ditës së zgjedhjeve. Megjithëse ky ndalim u respektua formalisht, disa politika të miratuara para këtij afati çuan në shpërndarjen e përfitimeve për grupe të caktuara zgjedhësish gjatë periudhës zgjedhore, duke përfshirë një bonus të posaçëm për pensionistët.<sup>61</sup> Më 9 maj, Këshilli i Ministrave zbatoi një ligj të dhjetorit 2024, duke hequr gjobot e vendosura midis viteve 2015 dhe 2024 për disa ndërtime të paligjshme, mosrespektimin e masave të COVID-19, si edhe për prodhuesit bujqësorë dhe blegtoralë, dukshëm me qëllim ndikimin te zgjedhësit.

<sup>58</sup> Z. Rama iu referua në mënyrë të përsëritur kundërshtarit të tij, z. Berisha, si “buf moçali” dhe drejtuesve të tjerë të opozitës si “krijesa moçali”. Nga ana e tij, z. Berisha e quajti z. Rama “Antikrisht”, “përbindësh” dhe qeverinë “narko-diktaturë”. Agron Shehaj, kryetar i Partisë “Mundësia”, e akuzoi Adriatik Lapajn, kryetarin e lëvizjes “Shqipëria Bëhet”, se kishte përfituar nga marrëveshje të brendshme në cilësinë e tij si avokat. Sipas raportimeve në media, në përgjigje të këtyre akuzave, z. Lapaj [paraqiti](#) një padi për shpifje.

<sup>59</sup> Për shembull, më 18 prill, Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale [promovoi](#) investimet e qeverisë në Spitalin Rajonal të Lezhës; më 19 prill, kryeministri, zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë [prezantuan](#) projektin e ri të gazifikimit në qytetin e Korçës. Më 28 prill, Ministri i Brendshëm prezantoi një projekt të ri për prodhimin e mjeteve ushtarake. Kryeministri [vizitoi](#) gjithashtu spitalin e saporinovuar bashkiak të Mirditës më 18 prill, Spitalin Psikiatrik në Vlorë më [27 prill](#), the ndërtimin e një shkolle të re në Tiranë më [28 prill](#), dhe promovoi investimet në Gjirokastrë më [3 maj](#). Më 9 maj, Kryeministri inauguroi Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorës dhe e përdori këtë inaugurim si mesazh fushate po atë ditë në një aktivitet zgjedhor.

<sup>60</sup> Aktivitete të tilla përfshinë Panairin e Turizmit në Berlin në muajin mars – ku morën pjesë disa ministra dhe Kryeministri dhe u mbulua gjerësisht në media – si dhe segmentin shqiptar të garës së çiklizmit Giro d’Italia, të planifikuar për periudhën 9–11 maj, duke përkruar me heshtjen zgjedhore dhe ditën e zgjedhjeve.

<sup>61</sup> Me një [Vendim](#) të 9 janarit, Këshilli i Ministrave u akordoi pensionistëve një bonus pranvere së bashku me pensionin mujor. Shpërndarja e shumave prej 10,000 lekësh (rreth 100 euro) ose 5,000 lekësh (50 euro), në varësi të nivelit të pensionit, filloi më 1 mars. Më 9 janar, Këshilli i Ministrave miratoi një skemë kreditimi pa interes për nëpunësit civilë dhe punonjës të tjerë të administratës publike, kurse më 10 janar një skemë ndihme shtetërore në formën e granteve për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme. Projektet bashkiake të buxhetuara për vitin 2024 dhe të nisura menjëherë para ose gjatë zgjedhjeve përfshinin: punime rrugore në Durrës, Himarë dhe Librazhd; shpallje procedurash tenderimi në Himarë, Mat, Roskovec dhe Shkodër; si edhe skema subvencionesh në Lezhë, Klos dhe Tiranë. Me një vendim të 7 majit, Këshilli i Ministrave miratoi krijimin e një zone të re të zhvillimit teknologjik dhe ekonomik në Shijak, autorizoi dhënien në përdorim të tokës dhe përcaktoi zhvilluesin e kësaj zone.

Për më tepër, në periudhën katërmujore para ditës së zgjedhjeve, institucionet publike dhe subjektet shtetërore duhet të raportojnë çdo aktivitet publik në KQZ të paktën pesë ditë më parë. KQZ-ja mund të ndalojë disa aktivitete nëse konsiderohen si përdorim i mundshëm i burimeve shtetërore, të cilat më pas nuk mund të raportohen në media. Nga 4,522 aktivitetet zyrtare të regjistruara gjatë kësaj periudhe, KQZ-ja ndaloi vetëm 18, duke ngritur dyshime mbi kapacitetin e saj për të shqyrtuar të gjitha njoftimet dhe interpretimin e ngushtë të ligjit. Megjithëse shumë prej këtyre aktiviteteve përmbushnin formalisht dispozitat ligjore, vëllimi i tyre krijoi mundësi fushate për qeverinë në detyrë, veçanërisht përmes institucioneve lokale në zonat ku zyrtarë të lartë të qeverisë shërbenin si koordinatorë politikë të PS-së.<sup>62</sup> Përdorimi i gjerë i aktiviteteve të tilla publike për qëllime zgjedhore forcoi më tej avantazhin e padrejtë të partisë në pushtet dhe zbehu vijën ndarëse mes shtetit dhe partisë, në kundërshtim me paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990.<sup>63</sup>

KQZ-ja vendosi 96 monitorues për të mbikëqyrur zbatimin e rregullave të fushatës dhe i publikoi raportet *online*. Monitoruesit nuk gjurmuan shpenzimet e fushatës dhe objekti i shkeljeve të raportuara ishte i kufizuar.<sup>64</sup> KQZ-ja mund të hetojë shkeljet administrative të lidhura me zgjedhjet me iniciativën e vet ose përmes ankesave të paraqitura *online* nga çdo palë e interesuar. Nga 166 ankesat e marra, një pjesë e konsiderueshme lidhej me përdorimin e burimeve publike, asfaltimin e rrugëve, partneritetet e ndaluara publike-private, ndihmën ekonomike, subvencionet dhe tenderët e prokurimit publik, të lidhura me drejtues institucioneve publike, kryetarë bashkish dhe ministra. Në shumicën e vendimeve të dhëna deri më 9 maj për këto çështje, KQZ-ja nuk konstatoi shkelje, duke argumentuar se buxhetet ishin alokuar që përpara periudhës së kufizimit katërmujor; në 37 raste, ajo vendosi të mos hapte hetim. Në përgjithësi, KQZ-ja mori një vendim vetëm për 118 nga ankesat deri në ditën e zgjedhjeve. Mungesa e një procedure të përshpejtuar për adresimin e ankesave ngre shqetësime lidhur me efikasitetin e sistemit aktual për hetimin dhe vendimmarrjen mbi shkeljet administrative të lidhura me zgjedhjet nga ana e KQZ-së.

*Për të garantuar kushte të barabarta gare, autoritetet duhet të marrin masa për të parandaluar keqpërdorimin e funksioneve publike dhe burimeve shtetërore. Duhet të vendosen sanksione proporcionale dhe dekurajuese në mënyrë të shpejtë ndaj shkeljeve të tilla.*

Misioni i ODIHR-it mori raportime të përhapura që pretendonin se punonjësit bashkiakë ishin vënë nën presion nga eprorët e tyre për të mbështetur ose marrë pjesë në fushatën e PS-së.<sup>65</sup> Megjithëse PS-ja organizoi disa aktivitete fushate të synuara ndaj grave, u ngritën shqetësime se disa pjesëmarrëse kishin marrë udhëzime nga punëdhënësit e tyre në sektorin publik për të marrë pjesë.<sup>66</sup> Shumë bashkëbisedues

<sup>62</sup> Numri më i lartë i aktiviteteve u regjistrua në bashkitë e qarkut Fier, ku Zëvendëskryeministrja është drejtuesja politike e PS-së. Numra të lartë u regjistruan gjithashtu në Lezhë, të drejtuar nga Ministri i Drejtësisë, dhe në Gjirokastrë, të drejtuar nga Ministrja e Turizmit. Bashkitë e drejtuara nga opozita regjistruan pak ose aspak aktivitete të tilla.

<sup>63</sup> Në paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990, Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së u angazhuan për “një ndarje të qartë ndërmjet shtetit dhe partive politike”

<sup>64</sup> Nga 11 janari deri më 8 maj, monitoruesit e KQZ-së dorëzuan 1,739 raporte, përfshirë 150 raportime për parregullsi, shumica lidhur me vendndodhjen e zyrave zgjedhore dhe materialeve të fushatës, si edhe materiale fushate të pidentifikuara si duhet.

<sup>65</sup> Pretendime dhe raportime të drejtpërdrejta për punonjës bashkiakë të vënë nën presion nga eprorët e tyre për të marrë pjesë në veprimtari të fushatës së PS-së u bënë në Durrës, Fier, Has, Korçë, Peshkopi, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë. Pretendime për presion ndaj punonjësve bashkiakë për të marrë pjesë në fushatën e PS-së, ose për ta mbështetur atë, përfshirë financiarisht, u bënë në Devoll, Elbasan, Gjirokastrë, Korçë, Lezhë, Pukë, Shkodër dhe Tropojë. Pretendime për presion ndaj punonjësve të sektorit publik për të përcjellë informacion për familjarët apo miqtë e tyre që jetojnë jashtë vendit u bënë në Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Lezhë, Shkodër dhe Tiranë. Më 7 maj, gjatë mitingut përmblyës të PD-së në Elbasan, zyrtarë të partisë informuan vëzhguesit e ODIHR-it se pjesëmarrësit ishin transportuar me autobusë nga bashkitë fqinje Cërrik dhe Belsh.

<sup>66</sup> Në 16 aktivitete të organizuara nga PS-ja për gratë, të vëzhguara nga vëzhguesit e ODIHR-it, shumica e pjesëmarrëseve ishin punonjëse të sektorit publik. Në katër prej këtyre aktiviteteve, disa pjesëmarrëse informuan ODIHR-in se u ishte kërkuar nga punëdhënësi që të merrnin pjesë.

të Misionit të ODIHR-it shprehën shqetësime mbi ndikimin e rrjeteve të patronazhimit në të gjithë vendin, duke pretenduar se premtime për punësim në sektorin publik, favore administrative, përfitime sociale dhe leje të ndryshme janë përdorur si mjet presioni për të siguruar vota. Misionit të ODIHR-it iu raportuan gjithashtu pretendime se zgjedhësit kishin frikë nga ndëshkimet për pjesëmarrje në aktivitete të partive të opozitës, si dhe raste intimidimit ndaj kandidatëve të opozitës dhe disa kandidatëve të partisë në pushtet.<sup>67</sup> Disa bashkëbisedues deklaruan se komunitetet vulnerabël ishin veçanërisht të ekspozuara ndaj presionit nga autoritetet publike për të votuar për PS-në. Praktika të tilla janë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare që kërkojnë që zgjedhësit të jenë të lirë nga ndikimi i padrejtë ose me forcë.<sup>68</sup>

Gjatë fushatës u ngritën disa pretendime për shitblerje votash dhe u hapën hetime në 37 raste.<sup>69</sup> Një numër bashkëbiseduesish të Misionit të ODIHR-it pretenduan se kishte lidhje midis partive politike dhe grupeve të krimit të organizuar në disa zona, dhe se disa grupe kriminale kishin intimiduar dhe kërcënuar zgjedhësit dhe, në disa raste, edhe kandidatët.<sup>70</sup>

*Për të ndihmuar në mbrojtjen e shprehjes së lirë të vullnetit të zgjedhësve, organet e rendit duhet të bëjnë çdo përpjekje për të identifikuar dhe hetuar të gjitha pretendimet për shkelje zgjedhore, në mënyrë të plotë, të shpejtë dhe transparente. Zgjedhësit duhet të informohen sistematikisht mbi mekanizmat e zbatueshëm për raportimin e shkeljeve, përfshirë mbrojtjen për sinjalizuesit dhe garancitë kundër pasojave negative.*

Fushata në rrjetet sociale nuk është e rregulluar në mënyrë të posaçme dhe asnjë autoritet rregullator nuk është caktuar me ligj për të monitoruar aktivitetet e fushatës në rrjetet sociale apo për të zbuluar rastet e dezinformimit, përmbajtjeve manipuluese dhe sjelljeve joautentike.<sup>71</sup> Megjithatë, KQZ-ja ngriti një njësi të posaçme për të monitoruar llogaritë në rrjetet sociale të 150 institucioneve publike gjatë fushatës dhe mori trajnim për zbulimin e rasteve të dezinformimit lidhur me zgjedhjet.<sup>72</sup> Nga 11 prilli deri më 9 maj, KQZ-ja konstatoi 10 postime nga institucione publike që mund të përbënin shkelje dhe i referoi ato për hetim administrativ. KQZ-ja vendosi të mos hetonte ankesat lidhur me postime të institucioneve publike që mbështesnin fushatën e PS-së. KQZ-ja bëri disa përpjekje për të bashkërenduar veprimet me Meta-n, por kjo nuk çoi në krijimin e një mekanizmi që do t'i mundësonte KQZ-së të sinjalizonte përmbajtje potencialisht manipuluese ose të kërkonte heqjen e tyre.<sup>73</sup> Fusha e veprimit dhe efektiviteti i monitorimit nga KQZ-ja të fushatës online mbetën të kufizuara.

<sup>67</sup> Raportime të drejtpërdrejta për kërcënime u bënë në Berat, Durrës dhe Fier. Pretendime se zgjedhësit hezitoin të merrnin pjesë në aktivitetet e partive opozitare nga frika e masave ndëshkuese u raportuan në të gjithë vendin, veçanërisht me raste konkrete dhe të detajuara në Durrës, Elbasan, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës dhe Tiranë. Për më tepër, u raportuan pretendime për intimidim nga policia ndaj zgjedhësve në Fier. Më 4 maj, familjarë të një kandidatëve të PS-së dyshohet se u kërcënuan në Lezhë.

<sup>68</sup> Shih paragrafin 19 të [Komentit të Përgjithshëm 25](#) të vitit 1996 të Komitetit për të Drejtat e Njeriut (KDNJ) mbi nenin 25 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP), ku thuhet se “[p]ersonat që gëzojnë të drejtën e votës duhet të jenë të lirë të votojnë për çdo kandidat [...] dhe të mbështesin ose kundërshtojnë qeverinë, pa ndonjë ndikim ose detyrim të padrejtë të çfarëdo lloji që mund të shtrembërojë ose pengojë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve.”

<sup>69</sup> Pretendime konkrete për blerje votash u bënë në Elbasan, Korçë, Mirditë, Shkodër dhe Tiranë.

<sup>70</sup> Pretendime të tilla u bënë ODIHR-it në Durrës, Elbasan, Tiranë dhe Vorë, ku u raportua se autorët e dyshuar kishin lidhje me grupe të krimit të organizuar.

<sup>71</sup> Shih seksionin II.3 të Raportit Shpjegues të [Deklaratës Interpretative](#) të vitit 2024 të Komisionit të Venecias mbi Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, sa i takon teknologjive digjitale dhe inteligjencës artificiale.

<sup>72</sup> Para zgjedhjeve, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative (BIRN) organizoi një trajnim për KQZ-në rreth metodave për monitorimin e gjuhës së urrejtjes, dezinformimit dhe shpenzimeve në rrjetet sociale. Përveç kësaj, KQZ-ja deklaroi se monitoroi llogaritë në Facebook të 77 subjekteve zgjedhore për reklama të paguara politike.

<sup>73</sup> Më 16 prill, KQZ-ja u takua me përfaqësues të kompanisë Meta në lidhje me zgjedhjet. Vëzhguesit e ODIHR-it iu drejtuan Metës për të diskutuar aktivitetet e saj për zgjedhjet e ardhshme, por nuk morën përgjigje.

*Pas konsultimeve gjithëpërfshirëse me palët e interesit, aktivitetet e fushatës dhe reklamat politike në rrjetet sociale, përfshirë financimin e tyre, duhet të rregullohen duke respektuar të drejtën e lirisë së shprehjes.*

Gjatë periudhës zgjedhore, Misioni i ODIHR-it ndoqi aktivitetet e fushatës në 23 llogari të partive politike, koalicioneve dhe kandidatëve kryesorë në *Facebook* dhe *Instagram*. Garuesit ishin aktivë në këto platforma, me fokus te videot, ndarja e përmbajtjes nga aktivitetet e fushatës dhe promovimi i premtimeve elektorale.

Llogaritë e PD-së, PS-së dhe Sali Berishës ishin më aktive. Edhe pse shumica e partive politike, përfshirë PD-në dhe PS-në, nënshkruan vullnetarisht një Kod Sjelljeje për Fushatat Dixhitale para periudhës zyrtare të fushatës, disa garues shpërndanë përmbajtje përçarëse, diskriminuese dhe manipuluese.<sup>74</sup> Fushata në rrjetet sociale shpesh përfshinte video të animuara, meme dhe përmbajtje të krijuar me inteligjencë artificiale.

Disa organizata të shoqërisë civile monitoruan fushatën në rrjetet sociale, përfshirë Rrjetin Ballkanik për Gazetari Investigative dhe Koalicionin për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, të cilat monitoruan reklamat politike të sponsorizuara në rrjetet sociale. Monitorimi tregoi raste të sjelljes së koordinuar joautentike të përdorur për të rritur artificialisht ndërveprimin, veçanërisht nga llogari të palëve të treta që shpërndanin reklama sulmuese kundër opozitës.<sup>75</sup>

Pavarësisht ndalimit të vendosur nga qeveria për platformën e rrjetit social *TikTok*, garuesit raportohet se e përdorën atë në mënyrë aktive për fushatë, veçanërisht Lëvizja Bashkë dhe drejtuesi i saj, si dhe z. Berisha.<sup>76</sup>

Vetëm 1 nga 11 subjektet zgjedhore pati drejtuese një grua. Kandidatet gra zhvilluan fushatë në të gjithë vendin, por patën vizibilitet të kufizuar në media. Disa parti përcollën mesazhe për rëndësinë e fuqizimit ekonomik të grave, por nuk pati debate domethënëse politike mbi çështje të një rëndësie të veçantë për gratë. Pengesat e hershme sistematike, përfshirë demokracinë e dobët brenda partive dhe qasjen e kufizuar në financim, vazhdojnë të pengojnë avancimin e grave në politikë.

*Për të rritur pjesëmarrjen politike të grave, financimi publik mund të lidhet me masa konkrete gjithëpërfshirëse. Partitë politike duhet të mendojnë për të ndërmarrë hapa për reformimin e mekanizmave të brendshëm partiakë për të rritur përfaqësimin e grave brenda strukturave partiake, përfshirë edhe aksesin e tyre në fonde.*

Aksesueshmëria e fushatës për personat me aftësi të kufizuara mbeti e kufizuar dhe përkthimi në gjuhën e shenjave nuk u siguroi në tubimet e fushatës. Disa parti demonstuan praktika gjithëpërfshirëse duke përfshirë kandidatë me aftësi të kufizuara në listat e tyre. Platformat politike ndryshonin në qasjen ndaj të drejtave të aftësisë së kufizuar dhe përfshirjes sociale, duke u shtrirë nga propozimet gjithëpërfshirëse për rritjen e përfshirjes sociale, rritjen e pensioneve dhe nisma punësimi, deri te advokimi i përgjithshëm për grupet vulnerabël pa detaje specifike.

<sup>74</sup> Për shembull, Kryeministri Edi Rama ndau një postim nga një aktivitet fushate në Dibër, më 18 prill, ku tha: “gjysma e burrave në këtë vend janë të prapambetur”. Në një postim nga një takim me pensionistë në Gjirokastrë më 22 prill, z. Rama tha: “Nëse zgjedh midis BE-së dhe moçalit, dhe zgjedh moçalin, do të thotë që nuk je mirë — politikisht je autik”. Më 14 prill, Zëvendëskryeministrja Belinda Balluku postoi në lidhje me PD-në: “Vjedhin, vrasin, shpifin dhe shajnë”; më 23 prill, z. Berisha deklaroi në lidhje me aleatët e Ramës: “Soji juaj do të shpallet terrorist... nuk do të ketë vend për ju në tokë”; më 24 prill, z. Berisha akuzoi z. Rama dhe znj. Balluku se po organizonin një “grabitje mafioze të tokës”. Z. Rama përdori shpesh video të gjeneruara nga inteligjenca artificiale në sulmet ndaj z. Berisha.

<sup>75</sup> Shih [artikullin](#) e 5 majit mbi raportin e BIRN-it.

<sup>76</sup> Shih një [artikull](#) të kompanisë së analitikës së të dhënave Pikasa.

## X. FINANCIMI I FUSHATËS

Financimi i fushatës rregullohet kryesisht nga Kodi Zgjedhor dhe Ligji për Partitë Politike. Pavarësisht disa ndryshimeve të fundit, nuk janë miratuar reforma gjithëpërfshirëse që nga viti 2020. Kuadrin aktual i mungon efikasiteti, gjë që cenon transparencën e financimit të fushatës dhe barazinë e mundësive për partitë dhe garuesit.

Partitë politike mund të financojnë fushatat me fonde publike dhe private, përfshirë fondet e veta, kreditë bankare dhe donacionet nga qytetarët dhe subjektet juridike vendase.<sup>77</sup> Rekomandimi i ODIHR-it për zgjerimin e financimit publik për të përfshirë edhe kandidatët e pavarur nuk u zbatua. Më 21 mars, shumë përpara fillimit të fushatës, KQZ-ja u shpërndau 131,201,816 lekë (rreth 1.3 milion euro) fonde publike njëmbëdhjetë subjekteve zgjedhore, në përpjesëtim me rezultatet e zgjedhjeve të kaluara. Në vitin 2025, tavan i vetëfinancimit u rrit nga 1 milion lekë në 3 milion lekë (rreth 30,000 euro). Donacionet, përfshirë ato në natyrë, kufizohen në 1 milion lekë (rreth 10,000 euro) për donacion, pa limit të shumës totale të kontributeve. Vetëm kontributet mbi 50,000 lekë (rreth 500 euro) duhet të paguhen përmes një llogarie të caktuar bankare. Kreditë nuk janë të kufizuara dhe nuk rregullohen posaçërisht, për shembull lidhur me detyrimet e shlyerjes. Megjithëse kërkohet me ligj, asnjë nga garuesit nuk publikoi një bazë të dhënash të donacioneve, kredive apo huave të marra, duke cenuar më tej transparencën. Për më tepër, KQZ-ja nuk u kërkoi të ndërmerrnin ndonjë veprim, pasi nuk disponon instrumentet ligjore për t'i detyruar që të zbatojnë këtë dispozitë ligjore.

Periudha e rregulluar me ligj përfshin shpenzimet e partive politike dhe koalicioneve nga momenti i shpalljes zyrtare të datës së zgjedhjeve deri në fund të fushatës, përfshirë ato të kryera para periudhës zyrtare të fushatës. Megjithatë, ligji nuk përmban udhëzime të qarta se cilat aktivitete parazgjedhore përbëjnë shpenzime fushate dhe i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe sanksioneve të mundshme, duke mos qenë në linjë me praktikën e mirë ndërkombëtare.<sup>78</sup>

*Në përputhje me praktikën e mira, ligji duhet të përcaktojë qartë se cilat aktivitete parazgjedhore përbëjnë shpenzime fushate, duke siguruar që ato t'i nënshtrohen raportimit të duhur, mbikëqyrjes dhe sanksioneve të mundshme.*

Tavani aktual i shpenzimeve për një parti ose koalicion është 326,456,950 lekë (rreth 3.3 milion euro).<sup>79</sup> Ndryshimet ligjore të vitit 2025 përjashtuan shpenzimet e kandidatëve nga kufijtë e shpenzimeve të partisë, pa vendosur një tavan të veçantë për kandidatët. Kjo paqartësi ligjore mund të lejojë partitë dhe koalicionet të anashkalojnë kufijtë e shpenzimeve, duke ndikuar tek transparenca dhe llogaridhënia dhe duke u dhënë një avantazh të tepruar partive më të mëdha.<sup>80</sup>

<sup>77</sup> Partitë politike me përfaqësim parlamentar marrin fonde çdo vit nga buxheti i shtetit. Partitë që kanë siguruar të paktën një për qind të votave në zgjedhjet e mëparshme parlamentare kanë të drejtë të marrin fonde publike për fushatën zgjedhore, të cilat shpërndahen proporcionalisht me pjesën e votës së marrë.

<sup>78</sup> Paragrafi 262 i [Udhëzimeve të përbashkëta të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias të vitit 2020 për Rregullimin e Partive Politike](#) parashikon se “Legjislacioni duhet të ofrojë udhëzime të qarta mbi atë se cilat aktivitete nuk lejohen gjatë fushatës parazgjedhore dhe të ardhurat dhe shpenzimet e përdorura për këto aktivitete në këtë periudhë duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit dhe sanksioneve të duhura.”

<sup>79</sup> Për këto zgjedhje, kufijtë e shpenzimeve për fushatën u rritën nga maksimumi trefish në maksimumi pesëfish të shumës më të lartë të marrë nga një subjekt zgjedhor nga fondet publike.

<sup>80</sup> Paragrafi 19 i [Komentit të Përgjithshëm nr. 25 të PNDCP-së](#) parashikon se “kufizimet e arsyeshme mbi shpenzimet në fushatë mund të jenë të justifikueshme, kur janë të nevojshme për të garantuar që zgjedhja e lirë e zgjedhësve të mos cenohet, ose procesi demokratik të mos shtrembërohet nga shpenzimet e tepruara në emër të ndonjë kandidati ose partie”. Paragrafi 248 i [Udhëzimeve të përbashkëta të vitit 2020 të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias për Rregullimin e Partive Politike](#) thekson se “Është e arsyeshme që një shtet të përcaktojë kritere për shpenzimet zgjedhore dhe një tavan maksimal shpenzimesh për pjesëmarrësit në zgjedhje.”

*Për të garantuar kushte të barabarta gare, kuadri ligjor duhet të parashikojë gjithashtu një tavan të arsyeshëm për shpenzimet e fushatës për kandidatët që garojnë në listat e partive ose koalicioneve.*

Shpenzimet e fushatës për aktivitetet online duhet të përfshihen në kufirin e përgjithshëm të shpenzimeve dhe të raportohen, pasi ligji kërkon raportimin e të gjitha shpenzimeve të fushatës. Megjithatë, fushata online, reklamat politike të paguara në platformat e rrjeteve sociale dhe shpenzimet nga palë të treta nuk janë të rregulluara, duke mundësuar përdorimin e pakontrolluar të fondeve gjatë fushatës.<sup>81</sup> Këto boshllëqe krijojnë hapësira për përdorimin e fondeve të paligjshme dhe të pagjurmueshme, si dhe për anashkalimin e rregullave të zbatueshme.

*Për të rritur transparencën, autoritetet duhet të konsiderojnë rregullimin e fushatës online dhe të fushatës nga palë të treta, si dhe të përcaktojnë kriteret për fushatat nga palë të treta dhe mekanizmat adekuatë të raportimit dhe sanksionimit.*

Garuesit janë të detyruar të dorëzojnë raportet e financimit të fushatës në KQZ përmes Platformës Elektronike të Raportimit Financiar brenda 60 ditëve nga shpallja zyrtare e rezultateve. Rekomandimi i mëhershëm i ODIHR-it për të futur raportimin financiar të ndërmjetëm përpara ditës së zgjedhjeve nuk u zbatua. Mungesa e raportimit të ndërmjetëm kufizon transparencën dhe i privon zgjedhësit nga informimi në kohë, duke mos qenë në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare për mbikëqyrjen e financimit të fushatës.<sup>82</sup> Disa parti vunë në dukje se kishin marrë trajnim dhe mbështetje nga KQZ-ja lidhur me kërkesat e raportimit. Edhe pse formularët e raportimit dhe platforma online janë përmirësuar teknikisht, disa bashkëbisedues të Misionit të ODIHR-it vazhduan të shprehin shqetësime për vështirësitë në kërkimin dhe krahasimin e të dhënave.

Brenda pesë ditëve nga shpallja e rezultateve, KQZ-ja emëron auditues për të shqyrtuar raportet e financimit të fushatës. Disa bashkëbisedues të Misionit të ODIHR-it shprehën shqetësime për kapacitetin e audituesve për identifikimin e financimeve të paligjshme dhe shpenzimeve të padeklaruara, përfshirë ato online, për shkak edhe të mandatit të tyre të kufizuar.

*Për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien, KQZ-ja duhet të pajiset me burime shtesë financiare dhe njerëzore, si edhe me një mandat të zgjeruar, që të mundësojë auditim kuptimplotë të raporteve të financimit të fushatës, përfshirë kompetencën për të hetuar burimet e donacioneve.*

<sup>81</sup> Sipas Meta Ad Library, nga 9 prilli deri më 8 maj, subjektet zgjedhore shpenzuan gjithsej deri në 21,410,830 lekë (rreth 217,870 euro) për reklama politike. Nga këto, PD shpenzoi 2,746,960 lekë (rreth 27,950 euro), Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut 1,173,220 lekë (rreth 11,940 euro), Lëvizja “Shqipëria Bëhet” 490,050 lekë (rreth 4,990 euro). Ndër kandidatët, Agron Shehaj, kryetar i Partisë “Mundësia”, kishte shpenzimet më të larta me 1,909,780 lekë (rreth 19,430 euro), Belind Këlliçi i PD-së me 763,100 lekë (rreth 7,770 euro) dhe Vullnet Sinaj i PS-së me 748,960 lekë (rreth 7,620 euro).

<sup>82</sup> Neni 7.3 i [Konventës së OKB-së kundër Korrupsionit \(UNCAC\)](#) kërkon që shtetet të marrin masa “për të rritur transparencën në financimin e kandidaturave për poste publike të zgjedhura”. Paragrafi 247 i [Udhëzimeve të përbashkëta të vitit 2020 të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias për Rregullimin e Partive Politike](#) parashikon se “Zgjedhësit duhet të kenë informacion të rëndësishëm mbi mbështetjen financiare të dhënë për partitë politike, pasi kjo ndikon në vendimmarrje dhe është një mjet për t’i mbajtur partitë përgjegjëse”. Shih gjithashtu paragrafin 261, ku thuhet se “Është praktikë e mirë të kërkojnë këto raporte: [...] Raporte që u japin organeve mbikëqyrëse dhe publikut informacion paraprak mbi të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës së partive dhe kandidatëve disa ditë para ditës së zgjedhjeve”

## XI. MEDIA

### A. MJEDISI MEDIATIK

Pavarësia, diversiteti dhe integriteti i lajmeve të disponueshme për zgjedhësit dëmtohen nga varësia e shumicës së mediave nga financimet jotransparente të interesave politike dhe të biznesit, shpesh të mbështetura në kontrata publike. Përqendrimi i pronësisë së mediave minon më tej pluralizmin e burimeve të lajmeve, në kundërshtim me standardet ndërkombëtare<sup>83</sup>. Sipas disa bashkëbiseduesve të Misionit të ODIHR-it, pronësia e disa kompanive të mëdha të shitjes së reklamave nga interesa politike pengon shpërndarjen e drejtë të të ardhurave nga reklamat, ndërsa mungesa e matjes së besueshme të audiencës pengon alokimin transparent dhe të përgjegjshëm të reklamave publike<sup>84</sup>. Shumica dërrmuese e mediave perceptohen si të lidhura me partinë në pushtet, PS-në.<sup>85</sup>

*Autoritetet shtetërore, për të përmbushur detyrimet e tyre pozitive sipas së drejtës ndërkombëtare, duhet të promovojnë një mjedis mediatik të pavarur dhe të larmishëm, të lirë nga ndikimi politik dhe ai korporativ. Duhet të miratohet një rregullim gjithëpërfshirës i pronësisë së mediave dhe të forcohet zbatimi i tij efektiv. Për më tepër, duhet të ndërmerren masa për të mbrojtur autonominë editoriale nga ndikimet e interesave të biznesit dhe politikës.*

Radiotelevizioni Publik Shqiptar (RTSH) nuk konsiderohet të ketë një audiencë të gjerë, dhe procedura bipartizane e emërimit të drejtimit të RTSH-së dhe të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) nuk siguron pavarësinë e tyre *de facto*.<sup>86</sup>

*Ndryshimet legjislative duhet të garantojnë depolitizimin efektiv dhe pavarësinë e mirëfilltë institucionale si të Radiotelevizionit Publik, ashtu edhe të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare. Këto ndryshime duhet të përfshijnë konsultime të gjera publike me median e pavarur dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile.*

Ndërhyrja e përhapur e pronarëve të mediave në autonominë editoriale, së bashku me autocensurën tek gazetarët, ndikon negativisht në informacionin që i ofrohet publikut. Përveç kësaj, gazetarët përballen me sulme të përsëritura verbale dhe, herë pas here, fizike nga zyrtarë publikë.<sup>87</sup> Më tej, gazetarët raportojnë se kanë akses gjithnjë e më të kufizuar te përfaqësuesit e qeverisë, përfshirë kryeministrin,

<sup>83</sup> Sipas [Monitorit të Pluralizmit të Medias 2024](#), të Institutit Universitar Evropian, katër pronarët kryesorë në tregun audioviziv kontrollojnë 72 për qind të të ardhurave dhe 87 për qind të audiencës. Paragrafi 40 i [Komentit të Përgjithshëm nr. 34 të Komitetit për të Drejtat e Njeriut të OKB-së \(KDNJ\)](#) parashikon se shtetet palë duhet të marrin masa të përshtatshme “për të parandaluar dominimin e tepruar të medias ose përqendrimin nga grupe private mediatike në situata monopoliste që mund të jenë të dëmshme për diversitetin e burimeve dhe pikëpamjeve.”

<sup>84</sup> Shih gjithashtu [vlerësimin](#) e Kryetarit të Shoqatës së Gazetarëve Shqiptarë

<sup>85</sup> Sipas [BIRN](#), ndër 10 televizionet më të mëdha (bazuar në të dhënat financiare), TV Klan dhe Top Channel zënë 64 për qind të tregut. I vetmi televizion ndër këto 10, që perceptohet i afërt me PD-në, Syri TV, në vitin 2023 “zinte 1.7% të të ardhurave totale të tregut televiziv, ose 113 milionë lekë. Të ardhurat e deklaruara ranë me 22% krahasuar me vitin 2022.”

<sup>86</sup> Më 6 shtator 2024, Drejtori i RTSH-së dha dorëheqjen pas shqetësimeve [të ngritura](#) lidhur me pozicionet që kishte mbajtur më parë në PS. Më 17 shkurt 2025, Parlamenti [shpërndau](#) Këshillin Drejtues të RTSH-së për parregullsi në përzgjedhjen e një Drejtori të ri të RTSH-së. Një Këshill i ri Drejtues u emërua më 17 mars, i cili më pas [zgjodhi](#) një Drejtor të ri më 25 prill 2025. Si pjesë e negociatave të anëtarësimit në BE, Shqipëria është angazhuar, në “Hartën Rrugore për Shtetin e së Drejtës”, të ndryshojë kuadrin ligjor “për të siguruar që rregullatori të ketë përbërje pluraliste, të përbëhet nga individë të kualifikuar, të përfaqësojë komunitetin mediatik dhe të gëzojë autonomi ndaj qeverisë”. “[Dialogu i Hapur për Lirinë e Shprehjes](#)”, i nisur nga BE-ja dhe KiE më 31 janar 2025, pritet nga aktorët të ofrojë rekomandime specifike për ndryshimet ligjore.

<sup>87</sup> Qendra Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe të Medias [raportoi](#) 45 incidente kundër lirisë së medias në vitin 2024. Më 27 mars 2024, Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve [u bëri thirrje](#) zyrtarëve publikë, përfshirë Kryeministrin Edi Rama, të ndalonin gjuhën fyese dhe sjelljen kërcënuese ndaj gazetarëve. Më 26 mars 2025, [safejournalists.net](#) [raportoi](#) një sulm fizik ndaj një gazetari nga një zyrtar i Bashkisë së Tiranës.

me një ulje të numrit të konferencave për shtyp dhe raste kur gazetarët pengohen të marrin pjesë në aktivitete, në kundërshtim me standardet ndërkombëtare.<sup>88</sup> Mbulimi editorial i lajmeve shpesh zëvendësohet nga materiale të përgatitura nga organet qeveritare, duke cenuar integritetin redaksional. Agjencia e Medias dhe Informacionit (AMI), nën varësinë e Kryeministrit, centralizon dhe filtron informacionin e dhënë për qeverinë dhe institucionet publike.<sup>89</sup> Disa media të themeluara nga shoqëria civile dhe të financuara nga donatorë ofrojnë gazetari investigativ dhe me interes publik, por janë prekur nga shkurtime të fundit të financimeve ndërkombëtare.<sup>90</sup> Në ditën e zgjedhjeve dhe atë pas zgjedhjeve, VAGJ-të e Misionit të ODIHR-it dhe organizatat e shoqërisë civile raportuan një numër rastesh të intimidimit dhe pengimit të punës së gazetarëve.<sup>91</sup>

## B. KUADRI LIGJOR

Në përgjithësi, Kushtetuta dhe legjislacioni ofrojnë mbrojtje për lirinë e shprehjes. Megjithatë, pavarësisht rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it, shpifja mbetet vepër penale. Gazetarët janë përballur me raste të shumta civile dhe penale për shpifje vitet e fundit, përfshirë raste të padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP).<sup>92</sup>

*Shpifja duhet të dekriminalizohet plotësisht dhe dispozitat civile për shpifjen të harmonizohen me standardet ndërkombëtare për lirinë e shprehjes.*

Më 22 prill 2025, Gjykata Kushtetuese rrëzoi vendimet e mëparshme që lejonin sekuestrimin e telefonave dhe kompjuterëve nga një gazetar që raportonte mbi një rast të krimit të organizuar nën hetim nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK). Gjykata e konsideroi mbrojtjen e burimeve të gazetarëve si pjesë integrale të lirisë së medias dhe, rrjedhimisht, të lirisë së shprehjes, duke e vlerësuar sekuestrimin si një ndërhyrje joproporcionale në të drejtën e aplikantit si edhe në të drejtën e publikut për informacion. Më herët, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut kishte urdhëruar një masë të përkohshme, duke pezulluar përpunimin e mëtejshëm të materialeve të sekuestruara deri në një vendim përfundimtar.<sup>93</sup>

Kodi i Transmetimit i vitit 2023 kërkon mbulim objektiv dhe të paanshëm të lajmeve. Megjithatë, Kodi Zgjedhor nuk siguron mbulim të drejtë të lajmeve për partitë joparlamentare, në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së, duke i vënë ato në një pozitë edhe më të pafavorshme në një mjedis tashmë të vështirë mediatik.<sup>94</sup>

<sup>88</sup> Paragrafi 13 i [Komentit të Përgjithshëm nr. 34 të KDNJ-së](#) parashikon se “[k]omunikimi i lirë i informacionit dhe ideve mbi çështjet publike dhe politike ndërmjet qytetarëve, kandidatëve dhe të zgjedhurve është thelbësor. Kjo nënkupton një shtyp dhe media të tjera të lira për të komentuar mbi çështjet publike pa censurë ose kufizime dhe për të informuar opinionin publik.”

<sup>89</sup> Në tetor 2021, pak përpara krijimit të Agjencisë së Informimit dhe Medias (AIM), gjashtë OJQ ndërkombëtare të medias [kërkuan](#) anulimin e themelimit të saj, duke paralajmëruar se ajo mund të “përdoret për të forcuar më tej kontrollin mbi qarkullimin e informacionit publik”.

<sup>90</sup> Sipas Qendrës për Gazetari të Cilësisë, gjashtë projekte të financuara nga Departamenti i Shtetit i SHBA-së ose u pezulluan ose u ndërprejnë. Ndër to ishin Rrjeti Investigativ Shqiptar (INA), që financonte dhe publikonte hetime, si edhe emisioni investigativ “31 minuta”, i transmetuar në të gjitha televizionet kryesore.

<sup>91</sup> Shih [safejournalists.net](http://safejournalists.net)

<sup>92</sup> Një [studim](#) i Safejournalists.net raportoi gjithsej 8 çështje penale dhe 65 çështje civile për shpifje në vitin 2023.

<sup>93</sup> Shih [Respublika.org](http://Respublika.org)

<sup>94</sup> Partitë që kanë fituar mbi 20 për qind të mandateve në zgjedhjet e mëparshme parlamentare duhet të marrin dyfishin e kohës në lajme, krahasuar me partitë e tjera parlamentare. Mbulimi i partive joparlamentare mbetet në diskrecionin e transmetuesve, por nuk mund të tejkalojë mbulimin e partive parlamentare me më pak se 20 për qind të vendeve në parlament. Paragrafi 7.8 i [Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990](#) kërkon që shtetet pjesëmarrëse të “Sigurojnë që asnjë pengesë ligjore apo administrative të mos cenojë aksesin e pakufizuar dhe jodiskriminues në media për të gjitha grupimet politike dhe individët që dëshirojnë të marrin pjesë në procesin zgjedhor”.

*Rregullat në Kodin Zgjedhor për shpërndarjen e kohës televizive në mbulimin editorial duhet të ndryshohen për të reduktuar avantazhin e dhënë partive më të mëdha parlamentare dhe për të siguruar një shpërndarje më të drejtë të kohës televizive për të gjithë garuesit.*

Më 6 mars, Këshilli i Ministrave ndaloi përkohësisht platformën TikTok, ndalim që nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare.<sup>95</sup> Sipas disa bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, ky ndalim pati edhe një ndikim tjetër të dëmshëm ndaj aftësisë së të gjithë kandidatëve, duke përfshirë edhe atyre të partive joparlamentare, për të bërë fushatë në kushte të barabarta.

### C. GJETJET E MONITORIMIT TË MEDIAS [AKSES NË INFORMACION TË DETAJUAR](#)

Sipas shumicës së bashkëbiseduesve të Misionit të ODIHR-it, pamjet filmike të fushatës zgjedhore të transmetuara në lajmet televizive siguroheshin nga vetë partitë politike, dhe jo nga gazetarët. Televizionet e monitoruara nga Misioni i ODIHR-it nuk i identifikonin pamjet e përgatitura nga partitë politike si të tilla, siç kërkohet nga Kodi Zgjedhor, dhe KQZ-ja nuk mori masa për të adresuar këtë praktikë.<sup>96</sup> Për më tepër, disa bashkëbisedues raportuan se disa intervista me kandidatë, të transmetuara në programe aktualiteti, ishin të paguara, në kundërshtim me ligjin. Si pamjet e prodhuara nga partitë në edicionet e lajmeve, ashtu edhe mbulimi mediatik i paguar i kandidatëve, në thelb barazohen me reklamën politike dhe vënë në disavantazh garuesit me më pak mundësi financiare.

*Pamjet e përgatitura nga partitë politike ose autoritetet qeveritare duhet të identifikohen si reklamë politike dhe për këtë arsye të mos lejohen në lajme dhe në programe të tjera editoriale. Duhet të merren masa efektive për të adresuar shkeljet dhe këto masa të zbatohen në kohë.*

Monitorimi nga Misioni i ODIHR-it tregoi se dy partitë më të mëdha dominuan mbulimin e lajmeve.<sup>97</sup> Në RTSH, A2 CNN, Top Channel dhe TV Klan, PS-ja mori përkatësisht 45, 46, 48 dhe 57 për qind, ndërsa PD-ASHM mori 41, 48, 45 dhe 43 për qind.<sup>98</sup> Mesatarisht, 83 për qind e këtij mbulimi u paraqit me ton neutral ose pozitiv. Asnjë nga garuesit e tjerë nuk mori më shumë se 5 për qind të mbulimit në ndonjë nga televizionet e monitoruara. Edhe pse u transmetuan rregullisht disa programe debati, ato nuk sollën së bashku kandidatë të njohur apo drejtues partish nga parti të ndryshme. RTSH-ja respektoi detyrimin e saj ligjor për t'u siguruar kohë transmetimi falas garuesve. Reklamat politike të paguara në televizion u blenë vetëm nga dy partitë dominuese. Mediat online të monitoruara shfaqën njëanshmëri më të theksuar (shih Shtojcën mbi Monitorimin e Medias). Si përfundim, mjedisi i kufizuar mediatik dhe moszbatimi me mirëbesim i kërkesave ligjore i privuan zgjedhësit nga informacioni i pavarur, i larmishëm dhe i besueshëm mbi garën zgjedhore.

<sup>95</sup> Paragrafi 43 i [Komentit të Përgjithshëm nr. 34 të KDNJ-së](#) parashikon se çdo kufizim ndaj faqeve të internetit, blogjeve apo platformave të tjera të komunikimit online duhet të jetë i ngushtë dhe i fokusuar te përmbajtja. Ndalimet e gjera ose të përgjithshme, “ndalimet gjithëpërfshirëse”, të funksionimit të këtyre sistemeve, përfshirë ofruesit e shërbimeve të internetit ose motorët e kërkimit, janë të papajtueshme me standardet ndërkombëtare për lirinë e shprehjes. Tre organizata të shoqërisë civile e sfiduan këtë vendim në Gjykatën Kushtetuese më 25 mars.

<sup>96</sup> AMA i dërgoi KQZ-së raporte monitorimi ditore dhe javore, në përputhje me ligjin. Megjithatë, monitorimi nuk vlerësoi tonin e mbulimit. Deri në ditën e zgjedhjeve, KQZ-ja kishte marrë 20 vendime, kryesisht për shkelje të dispozitave për reklamat e paguara dhe sondazhet e opinionit publik. Raporti i monitorimit që mbulonte periudhën 1–10 maj iu dorëzua KQZ-së vetëm më 19 maj, një javë pas zgjedhjeve.

<sup>97</sup> Nga 8 prilli deri më 9 maj, Misioni i ODIHR-it monitoroi në mënyrë sasiore dhe cilësore katër televizione dhe tre media online: RTSH, TV Klan, Top Channel dhe A2 CNN, si edhe panorama.al, lapsi.al dhe reporter.al.

<sup>98</sup> Shifrat përjashtojnë mbulimin e aktorëve politikë në cilësinë e tyre institucionale. Programet e aktualitetit dhe debatit shfaqën më shumë pabarazi.

## XII. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE ZGJEDHORE

Kuadri ligjor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore përfshin procedura administrative, të ndjekura nga mundësia e ankimit gjyqësor. Vëzhguesit mund të ankimojnë vetëm refuzimin e akreditimit të tyre, ndërsa zgjedhësit mund të kundërshtojnë vetëm përjashtimin e tyre nga lista e zgjedhësve përmes gjykatave të rrethit. Vetëm partitë politike, dhe jo kandidatët individualë në lista, mund të kundërshtojnë rezultatet e zgjedhjeve. Rekomandimi i mëparshëm i ODIHR-it për zgjerimin e aksesit në mjete juridike efektive në mosmarrëveshjet zgjedhore nuk u zbatua. Kjo qasje e ngushtë ndaj legjitimitetit juridik është në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe praktikat e mira.<sup>99</sup>

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) shqyrton ankesat kundër vendimeve të KQZ-së dhe KZAZ-ve, përfshirë ato që kundërshtojnë rezultatet e zgjedhjeve, dhe duhet të vendosë brenda 10 ditësh. KAS gjithashtu mund të vendosë sanksione edhe me kërkesë të KQZ-së. Ankesat dhe apelimet kundër të gjitha vendimeve të tjera të KQZ-së mund t'i drejtohen Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit të Tiranës, vendimet e të cilit janë përfundimtare. Deri më 20 maj, KAS-i shqyrtoi 20 ankesa kundër vendimeve të KQZ-së, kryesisht lidhur me parregullsi të supozuara gjatë periudhës para fushatës. Ai pranoi 12 ankesa, rrëzoi pesë vendime të KQZ-së dhe vendosi katër gjopa administrative prej 3,000 lekësh ndaj institucioneve publike për mosrespektimin e detyrimit për të raportuar aktivitetet dhe për neglizhencën e anëtarëve të KZAZ-ve.<sup>100</sup> Ankesat e tjera nuk u pranuan. Procesi ishte transparent, me seanca publike dhe pjesëmarrje të palëve të përfshira. Edhe pse vendimmarrja e KAS-it ishte përgjithësisht e argumentuar mirë, ajo reflektoi një interpretim të ngushtë të rregullave për përdorimin e burimeve administrative gjatë fushatës, duke e kufizuar zbatimin e tyre rreptësisht në periudhën zyrtare të fushatës,<sup>101</sup> në kundërshtim me praktikat e mira zgjedhore.<sup>102</sup> Deri më 20 maj, Kolegji Zgjedhor shqyrtoi dhe rrëzoi katër ankesa.<sup>103</sup> Seancat ishin publike dhe vendimet u publikuan të arsyetuara në faqen e tij të internetit, megjithëse me vonesë.

Deri më 7 korrik 2025, në KAS u paraqitën 22 ankesa lidhur me rezultatet e zgjedhjeve. Dhjetë prej tyre u rrëzuan në fazën e shqyrtimit paraprak, ndërsa 12 u pranuan për shqyrtim në themel. Në katër raste që kishin të bënin me Dibrën, Tiranën, Durrësin dhe Fierin, KAS-i urdhëroi rinumërimet. Rinumërimi në

<sup>99</sup> Paragrafi 5.10 i [Dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990](#) angazhon shtetet pjesëmarrëse të garantojnë për këdo “mjete efektive të ankimit kundër vendimeve administrative, në mënyrë që të garantohet respektimi i të drejtave themelore dhe integriteti ligjor”. Seksioni II.3.3.f i [Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias](#) rekomandon: “Të gjithë kandidatët dhe të gjithë zgjedhësit e regjistruar në zonën zgjedhore përkatëse duhet të kenë të drejtën e ankimit. Mund të vendoset një kuorum i arsyeshëm për ankimet e zgjedhësve mbi rezultatet e zgjedhjeve”.

<sup>100</sup> Pas 11 majit, PS-ja paraqiti një ankim ndaj vendimit të Komisionerit për ndarjen e përkohshme të zarfeve të votimit nga jashtë që vinin nga Greqia. KSHZ-ja e pranoi ankimit dhe e shpalli të pavlefshëm vendimin, duke vlerësuar se Komisioneri kishte tejkaluar kompetencat dhe se nuk ka dispozita ligjore për një procedurë të tillë. Kolegji Zgjedhor e rrëzoi ankesën, pasi ndërkohë KQZ-ja kishte zbatuar vendimin e KSHZ-së dhe kishte urdhëruar rinumërimin e fletëve të votimit nga Greqia.

<sup>101</sup> Neni 91.1 i Kodit Zgjedhor parashikon se “Përveç rasteve të parashikuara me ligj, burimet e organeve ose enteve publike të nivelit qendror ose vendor, apo të çdo lloji tjetër enti ku shteti zotëron kapital ose kuota dhe/ose emëron shumicën e organit mbikëqyrës ose të organit administrativ të entit, nuk mund të përdoren apo vihen në mbështetje të kandidatëve, partive apo koalicioneve politike në zgjedhje, pavarësisht burimit të kapitalit apo pronësisë”. Ky nen nuk parashikon qartë periudhën e zbatimit të kësaj dispozite dhe KSHZ-ja e interpretoi atë si të zbatueshme vetëm gjatë fushatës zyrtare njëmuajore.

<sup>102</sup> Neni 13 i [Udhëzimeve të përbashkëta të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias të vitit 2016](#) për parandalimin dhe reagimin ndaj keqpërdorimit të burimeve administrative gjatë proceseve zgjedhore parashikon një përkufizim më të gjerë të procesit zgjedhor, që “përfshin mënyrat e shumta në të cilat burimet administrative mund të keqpërdoren gjatë gjithë procesit zgjedhor, jo vetëm gjatë periudhës zyrtare të fushatës zgjedhore.”

<sup>103</sup> Këto kishin të bënin me regjistrimin e partive politike, dizajnin e fletës së votimit, përdorimin e pajisjeve të votimit dhe numërimin elektronik, si edhe fletët e votimit nga jashtë vendit që vinin nga Greqia.

Fier solli ndryshime në rezultat. Në tre rastet e tjera, rinumërimet nuk patën ndikim në rezultat. Të gjitha ankesat e tjera u rrëzuan për mungesë provash mbështetëse.<sup>104</sup>

Kodi Penal parashikon 15 vepra penale të lidhura me zgjedhjet, shumica nën kompetencën e Prokurorisë së Përgjithshme. Deri më 20 maj, procedime penale ishin nisur në 34 nga 87 rastet e pretenduara për krime zgjedhore, përfshirë keqpërdorimin e funksionit publik për qëllime zgjedhore, shkeljen e fshehtësisë së votës dhe pengimin ose intimidimin e zgjedhësve.<sup>105</sup> Në Elbasan u lëshuan katër urdhra ndalimi, ndërsa shtatë persona u kapën në flagrancë duke kryer vepra penale.<sup>106</sup>

SPAK-u ka juridiksion mbi rastet e korrupsionit zgjedhor dhe krimet që përfshijnë zyrtarë të lartë publikë ose krimin e organizuar. Për herë të parë, SPAK-u krijoi një njësi hetimore kombëtare dhe nisi një platformë online për raportimin e shkeljeve zgjedhore.<sup>107</sup> Deri më 11 maj, SPAK-u kishte nisur 40 procedime penale nga 189 raportime, kryesisht lidhur me pretendime për korrupsion. Veçanërisht, SPAK-u nisi nëntë procedime me iniciativën e vet. Bashkëpunimi midis SPAK-ut, KQZ-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme, i bazuar në një protokoll ndërinstitucional, lehtësoi shkëmbimin e informacionit mbi krimet zgjedhore, prioritizimin e hetimeve dhe u vlerësua pozitivisht nga bashkëbiseduesit e Misionit të ODIHR-it. SPAK-u u perceptua gjerësisht si një institucion i besueshëm me efekt të mundshëm parandalues. Megjithatë, disa bashkëbisedues shprehën shqetësime mbi efektivitetin e policisë në trajtimin e shkeljeve të lidhura me zgjedhjet, veçanërisht atyre që përfshijnë rrjete kriminale të organizuara.

### XIII. PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE

Kushtetuta e Shqipërisë parashikon të drejta të plota politike, civile dhe sociale për pakicat, dhe Kodi Zgjedhor garanton të drejtën e votës dhe të drejtën e kandidimit për të gjithë shtetasit, pavarësisht prejardhjes etnike, racës, fesë apo gjuhës. Në Shqipëri ka nëntë pakica kombëtare të njohura dhe, sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2023, rreth 2.5 për qind e popullsisë identifikohet si pjesë e një pakice kombëtare.<sup>108</sup>

Përfaqësuesit e pakicave në përgjithësi patën mundësi të marrin pjesë lirshëm si zgjedhës dhe si kandidatë, duke kandiduar si në partitë kryesore kombëtare ashtu edhe në tre parti të pakicave kombëtare.<sup>109</sup> Çështjet e lidhura me pakicat kombëtare ose etninë nuk ishin të theksuara gjatë fushatës dhe kandidatët e pakicave shpesh u fokusuan te çështje që prekin popullsinë e gjerë. Disa kandidatë nga pakica greke e paraqitën çështjen e të drejtave të pronësisë si një problem që prek në mënyrë disproporcionale komunitetin e tyre.

Nuk u vunë re kufizime në përdorimin e gjuhëve të pakicave gjatë fushatës. KQZ-ja përgatiti materiale zgjedhore në gjuhët e pakicave kombëtare zyrtarisht të njohura. Megjithëse shumica e bashkëbiseduesve

<sup>104</sup> Në një rast që lidhej me kërkesën për anulimin e procesit zgjedhor në qarkun Dibër, kërkesa për anulim u rrëzua, por u bënë ndryshime në tabelën përmbledhëse për të pasqyruar korrigjimet në numërimin e votave ndërmjet kandidatëve të PD-së.

<sup>105</sup> Pesë procedime u regjistruan në Prokurorinë e Fierit, tetë në Elbasan, katër në Tiranë, tre respektivisht në Gjirokastër dhe Lezhë, dy në Shkodër, Dibër, Sarandë, Korçë dhe nga një në Durrës, Vlorë dhe Kukës.

<sup>106</sup> Katër në Tiranë, një në Elbasan, Lezhë dhe Fier.

<sup>107</sup> Nga 189 kallëzime penale të regjistruara nga janari deri më 11 maj, 65 u paraqitën nga qytetarë nëpërmjet platformës online të SPAK-ut, dhe pjesa tjetër nga policia, PD-ja dhe Prokuroria e Përgjithshme.

<sup>108</sup> [Ligji për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare](#), në fuqi që nga viti 2017, njeh pakicat kombëtare: arumune, boshnjake, bullgare, egjiptiane, greke, maqedonase, malazeze, rome dhe serbe.

<sup>109</sup> Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut dhe Partia për Evropianizmin dhe Integrimin e Shqipërisë ishin pjesë e koalicionit të udhëhequr nga PD-ja. Aleanca Maqedonase për Integrim Evropian kishte marrëveshje zgjedhore me PS-në, dhe kryetari i saj ishte përfshirë në listën e PS-së.

të Misionit të ODIHR-it nuk kishin parë përdorim apo shpërndarje të këtyre materialeve, ata konfirmuan se shumica e individëve që u përkasin pakicave kombëtare flasin shqip dhe se gjuha nuk përbën pengesë për pjesëmarrjen.<sup>110</sup>

Asnjë parti e pakicave kombëtare nuk fitoi mandat në parlament në këto zgjedhje. Disa bashkëbisedues të Misionit të ODIHR-it argumentuan se sistemi zgjedhor aktual, i cili kërkon daljen me kandidatë në të gjitha qarqet, përbën një pengesë për partitë e pakicave kombëtare që synojnë përfaqësim parlamentar. Gjithashtu, sistemi i listave të mbyllura/të hapura – i cili u jep përparësi kandidatëve të renditur në listat e mbyllura dhe jo kandidatëve që preferohen nga listat e hapura – e bën të pamundur që kandidatët e pakicave kombëtare që kandidojnë me një nga partitë e mëdha kombëtare të marrin mjaftueshëm vota për të hyrë në parlament.

Sipas disa bashkëbiseduesve, nismat për edukimin e zgjedhësve për komunitetet romë janë shtuar krahasuar me zgjedhjet e mëparshme.<sup>111</sup> Megjithatë, anëtarët e komunitetit rom në disa zona të vendit vazhduan të ishin të painformuar për procedurat zgjedhore dhe nuk morën edukim specifik për mënyrën se si votohej.<sup>112</sup> Misioni i ODIHR-it vërejti se votuesit romë në disa zona nuk ishin të qartë për vendndodhjen e qendrave të tyre të votimit, pjesërisht për shkak të komunikimit të pamjaftueshëm zyrtar.<sup>113</sup> Përpjekjet për të blerë vota nga komunitetet romë dhe egjiptiane mbetën një problem i konsiderueshëm.<sup>114</sup> Megjithëse këto praktika të parregullta synonin përgjithësisht grupet vulnerabël, ato prekën në masë më të madhe disa pakica kombëtare.

#### XIV. VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE

Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgimin vendas dhe atë ndërkombëtar në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore. Në mënyrë gjithëpërfshirëse, KQZ-ja akreditoi 3,814 vëzhgues gjithsej nga 47 organizata vendase dhe 30 organizata ndërkombëtare.<sup>115</sup> Organizatat e shoqërisë civile informuan Misionin e ODIHR-it se mungesa e financimeve, veçanërisht nga donatorët ndërkombëtarë, uli kapacitetin e tyre për të kryer një vëzhgim gjithëpërfshirës dhe për të dërguar një numër të mjaftueshëm vëzhguesish ditën e zgjedhjeve. Për shembull, vëzhguesit vendas nuk ishin të pranishëm në 89.5 për qind të QV-ve të vëzhguara gjatë hapjes së votimit. Partitë dhe koalicionet parlamentare mund të caktonin përfaqësues të përhershëm pranë KQZ-së. Subjektet zgjedhore mund të caktonin një vëzhgues pranë çdo KZAZ-je dhe çdo KQV-je, si dhe pranë çdo GNV-je, përfshirë ato për votimin nga jashtë vendit.

#### XV. DITA E ZGJEDHJEVE

Dita e zgjedhjeve ishte përgjithësisht e qetë dhe transparente, por në shumë vende u vu re mosrespektim i procedurave gjatë hapjes së procesit dhe gjatë votimit, si edhe disa raste të raportuara të intimidimit dhe nxitjes së votuesve. Në përgjithësi, vëzhguesit patën akses të mjaftueshëm për të vëzhguar të gjithë

<sup>110</sup> KQZ-ja informoi Vëzhguesit e ODIHR-it se posterë në gjuhën maqedonase ishin vendosur krahas atyre në shqip në qendrat e votimit në Pustec dhe posterë në greqisht në qendrat e votimit në Dropull dhe Finiq. Videot e edukimit të zgjedhësve, të transmetuara në rrjetet sociale, si edhe fletëpalosjet informuese për zgjedhësit u përkthyen në tetë gjuhë të pakicave dhe iu dorëzuan Komitetit Shtetëror për Pakicat Kombëtare, që të shpërndaheshin në rajonet përkatëse nga përfaqësuesit e tyre.

<sup>111</sup> Kjo iu raportua Misionit të ODIHR-it në Fier dhe Vlorë.

<sup>112</sup> Për shembull, siç u raportua në Tiranë. Megjithatë, KQZ-ja bashkëpunoi me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri për të organizuar takime informuese me anëtarë të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në disa bashki.

<sup>113</sup> Kjo iu raportua Misionit të ODIHR-it në Tiranë.

<sup>114</sup> Kjo iu raportua Misionit të ODIHR-it në Fier, Korçë, Tiranë dhe Vlorë.

<sup>115</sup> Bazuar në shifrat e vëna në dispozicion nga KQZ-ja, u akredituan 2,879 vëzhgues vendas dhe 935 vëzhgues ndërkombëtarë.

procesin. Numri i madh i ndryshimeve të vonshme të anëtarëve të KQV-ve të nominuar nga partitë politike, madje edhe në prag të zgjedhjeve, pati ndikim negativ në respektimin e procedurave të votimit dhe uli në mënyrë efektive transparencën e përbërjes së KQV-ve. Në orën 20:00 të ditës së zgjedhjeve, KQZ-ja njoftoi një pjesëmarrje prej 42.3 për qind.

## A. HAPJA, VOTIMI DHE MBYLLJA

Misioni Ndërkombëtar i Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MNVZ) vëzhgoi hapjen në 127 qendra votimi, duke e vlerësuar procesin negativisht në gati një të tretën e rasteve të vëzhguara. Numri i lartë i vlerësimeve negative lidhej kryesisht me hapjen me vonesë dhe me mosrespektimin e disa procedurave. Në shumicën dërrmuese të qendrave të vëzhguara, votimi filloi me vonesë – në 28 raste më vonë se 30 minuta – shpesh për shkak të problemeve teknike ose mungesës së materialeve. Në 26 raste, anëtarët e KQV-ve nuk ishin të familjarizuar me procedurat e hapjes, kurse në 17 raste kutia e votimit nuk iu tregua bosh të pranishmëve. Në 9 vëzhgime, procedurat për konfigurimin e pajisjes së identifikimit biometrik nuk u ndoqën. Në 12 KQV, persona të paautorizuar udhëzonin ose ndërhyenin në punën e komisionit. Në qendrat me votim elektronik, vëzhguesit e MNVZ-së raportuan raste të shumta të mosndjekjes së procedurave nga ana e anëtarëve të KQV-ve.

Procesi i votimit u vlerësua pozitivisht në shumicën e rasteve. Megjithatë, në 4.6 për qind të 1,343 vëzhgimeve – një përqindje relativisht e lartë – procesi u vlerësua negativisht, kryesisht për shkak të mangësive procedurale dhe disa rasteve të presionit ndaj votuesve. Vëzhguesit e partive ishin të pranishëm në 79 për qind të qendrave të vëzhguara, ndërsa vëzhguesit vendas u panë vetëm në 8 për qind të tyre.<sup>116</sup> Mungesa e vëzhguesve vendas në shumë qendra uli nivelin e kontrollit të procesit. Gratë përbënin 30 për qind të anëtarëve të KQV-ve dhe 25.5 për qind të kryetarëve të qendrave të votimit të vëzhguara.

Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan se në 23 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara, votuesit nuk mund të identifikoheshin gjithmonë nga pajisjet e identifikimit të votuesve, dhe në 24 për qind të qendrave të votimit votuesit nuk kontrolloheshin gjithmonë për shenja boje. Disa defekte të pajisjeve të identifikimit biometrik shkaktuan ndërprerje të procesit, ndërsa në 23 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara, shenjat e gishtave të disa votuesve nuk mund të lexoheshin si duhet. Organizimi i qendrave të votimit u vlerësua i papërshtatshëm në 5 për qind të vëzhgimeve, duke cenuar fshehtësinë e votës, e cila nuk u respektua gjithmonë në 12 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara. Fshehtësia e votës u cenua gjithashtu nga ndërhyrja e vëzhguesve të partive ose anëtarëve të KQV-ve. Votimi në grup, kryesisht votimi familjar, u vërejt në 11 për qind të qendrave të votimit, dhe votimi me prokurë, shpesh për anëtarë të familjes, në 3 për qind. Njohja e procedurave të votimit nga zgjedhësit u vlerësua negativisht në 13 për qind të vëzhgimeve, duke treguar nevojën për edukim më të gjerë të votuesve mbi procedurat e reja të votimit pas futjes së listave preferenciale.

Gjatë ditës u vërejtën disa shkelje dhe incidente të rëndësishme. MNVZ-ja vuri re tension ose intimidim në 4 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara, shpesh duke përfshirë vëzhgues ose përfaqësues të partive që qëndronin pranë hyrjeve të qendrave të votimit dhe ndërvepronin me votuesit ose ndërhyenin në punën e KQV-ve. Persona të paautorizuar, përfshirë aktivistë partie, ishin të pranishëm në 2 për qind të qendrave, duke ndërhyrë në disa raste. Në 2.4 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara pati sinjale se votuesit nxiteshin të votonin për një kandidat të caktuar, duke përfshirë edhe pretendimet për blerje votash. Në 3 për qind të qendrave të votimit, vëzhguesit raportuan se kishin parë persona të paautorizuar që regjistronin kush votonte. Pas mbylljes së votimit, KQZ-ja raportoi se kishte referuar pesë incidente në prokurori, dy prej të cilave në Tiranë dhe të tjerat në Elbasan, Korçë dhe Berat.

<sup>116</sup> Pas raportimeve për disa akreditime të falsifikuara, Komisioni Rregullator i KQZ-së revokoi të gjitha akreditimet e vëzhguesve të partive për qarkun Vorë në ditën e zgjedhjeve.

*KQZ-ja duhet të marrë masa për të parandaluar intimidimin dhe ndikimin e padrejtë mbi votuesit në qendrat e votimit, duke forcuar trajnimin dhe mandatin e koordinatorëve të sigurisë së qendrave të votimit, për të siguruar që ata të jenë politikisht të pavarur dhe të fuqizuar të veprojnë në mënyrë efektive ditën e zgjedhjeve.*

Sa i përket votimit elektronik, vëzhguesit e MNVZ-së vunë re se, megjithëse procesi u zhvillua përgjithësisht pa probleme madhore, u evidentuan disa shqetësime. Shumë votues dukeshin të pafamiljarizuar me pajisjen e votimit dhe disa nuk arritën të votonin brenda afatit tre-minutësh. Disa anëtarë të KQV-ve dhe operatorë të teknologjisë nuk ishin trajnuar sa duhet mbi procedurat përkatëse dhe nuk e kishin të qartë rolin e tyre. Në disa vende të vëzhguara, votuesit që kërkonin ndihmë ndihmoheshin kryesisht nga operatorët, por pa përdorur materialet vizuale të disponueshme që ishin vendosur në qendrat e votimit. Operatorët ishin trajnuar të mos “kalonin vijën e padukshme të fshehtësisë”, dhe vëzhguesit raportuan se ata tregonin kujdes të madh për të mos kaluar në anën e ekranit ku votonin votuesit, madje edhe kur u kërkohej ndihmë.

Mungesa e aksesueshmërisë së duhur për personat me aftësi të kufizuara u vërejt në 50 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara. Numri i madh i qendrave të votimit të paaksesueshme për votim të pavarur tregoi qartazi nevojën për përpjekje më të mëdha për të siguruar akses për të gjithë votuesit. Për më tepër, organizimi i brendshëm i qendrave të votimit u konsiderua i papërshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara në 24 për qind të qendrave të vëzhguara. Kjo, e kombinuar me mungesën e një metode votimi për votuesit me pamundësi lëvizjeje, të shtruar në spital apo me probleme të mobilitetit, mund të ketë ndikuar negativisht në pjesëmarrjen e tyre.

Mbyllja e votimit u vlerësua pozitivisht nga vëzhguesit e MNVZ-së në 86 nga 88 raportet e marra. KQV-të ndoqën procedurat e mbylljes në shumicën e rasteve, megjithëse në katër raste u raportua njëfarë tensioni. Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan shumë pozitivisht për dorëzimin e materialeve në Vendet e Numërimit të Votave, edhe pse pati mbipopullim në disa prej tyre.

Transmetimi i rezultateve të votimit elektronik nga pajisjet drejtpërdrejt në KQZ në mbyllje të votimit u anulua për shkak të një kërkesë të PD-së për të shmangur publikimin para kohe të rezultateve. Ajo që ndodhi ishte që pajisjet e votimit që përmbanin “kutitë elektronike të votimit” u dërguan në KZAZ-të përkatëse në Tiranë dhe Vorë, ku u zhvilluan pilotimet, që numërimi të fillonte mëngjesin e 12 majit. Ky proces pati vonesa dhe shkaktoi konfuzion në publik.

## **B. NUMËRIMI DHE REZULTATET**

Vëzhguesit e MNVZ-së ndoqën numërimin në 66 nga 93 QNV. Prosesi u vlerësua negativisht në 8 raste. Problemet përgjithësisht kishin të bënin me tensione (9 raste), mbipopullim të ambienteve (7 raste), mungesë të aksesit të plotë në proces (12 raste) dhe disa raste ndërhyrje nga vëzhgues të partive (6 raste).<sup>117</sup> Ishin 12 kuti votimi të identifikuar nga KQZ-ja si të parregullta dhe që nuk u përfshinë në numërim deri pas verifikimit përfundimtar.<sup>118</sup> Vëzhguesit e MNVZ-së vlerësuan negativisht numërimin individual të kutive të votimit në 8 raste, kryesisht për shkak të mangësive të vërejtura procedurale dhe mangësive sa i takon transparencës, si p.sh. mosnumërimi fillimisht i fletëve të votimit të papërdorura dhe mosdemonstrimi i fletëve të votimit para kamerave të vendosura për këtë qëllim siç kërkohej me ligj.

<sup>117</sup> Në Durrës, vëzhguesit e Misionit Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MNVZ) raportuan raste personash të paautorizuar me akreditime të shkruara me dorë në grupet e numërimit të votave.

<sup>118</sup> Neni 115.3 i Kodit Zgjedhor përcakton se çfarë konsiderohet një kuti votimi e parregullt dhe që vlerësohet gjatë dorëzimit në qendrën e numërimit; kriteret përfshijnë mungesën e vulave të sigurisë ose përdorimin e një kutie jo standarde.

Në përgjithësi, procesi i numërimit u zhvillua në mënyrë të rregullt, por në shumë vende numërimi, vëzhguesit e MNVZ-së vërejtën një atmosferë kaotike dhe kontestime të disa fletëve të votimit në vende të ndryshme. Vëzhguesit raportuan gjithashtu vonesa në shumë zona, për shkak të mbërritjes së vonuar të numëruesve, trajnimit në minutën e fundit të GNV-ve dhe emërimit me vonesë të shumë anëtarëve të GNV-ve.<sup>119</sup> Në Dibër dhe Elbasan, vëzhguesit e MNVZ-së raportuan se zyrtarë të KQZ-së po kryenin trajnime të anëtarëve të qendrave të numërimit në mesnatë, para fillimit të numërimit, duke treguar përgatitje të pamjaftueshme si pasojë e zëvendësimeve me vonesë të anëtarëve të propozuar nga partitë. Sipas KQZ-së, në 30 për qind të GNV-ve të mëdha, partitë politike vazhduan të ndryshonin anëtarët e grupeve të numërimit deri në shpalljen e rezultateve për listat e mbyllura, duke ndikuar në shpejtësinë e procesit të numërimit. Kopjet e protokolleve të rezultateve nuk iu dhanë vëzhguesve të partive në 19 raste, duke kufizuar transparencën.

*Për të forcuar kapacitetin dhe profesionalizmin e Grupeve të Numërimit të Votave, KQZ-ja duhet të zhvillojë sesione të posaçme trajnimi mbi procedurat e numërimit dhe të hartojë një program të standardizuar trajnimi, duke përfshirë manuale dhe fletë informuese të kuptueshme për procesin e numërimit.*

Në shumicën e rasteve, MNVZ-ja vërejtë se numërimi ishte transparent dhe se procedurat u respektuan. Çdo tavolinë numërimi ishte e pajisur me kamerë dhe ekrane që u mundësonin vëzhguesve të ndiqnin procesin. Procesi u ndoq gjerësisht nga vëzhguesit e partive. Megjithatë, vëzhguesit e MNVZ-së vunë re se disa protokolle të shkruara me dorë nuk përputheshin me rezultatet e tabuluara në mënyrë digjitale, pati vonesa në shpërndarjen e kopjeve të protokolleve për vëzhguesit e partive dhe, në një rast, numërimi u pezullua përkohësisht, çka çoi në tërheqjen nga KQZ-ja të akreditimit të vëzhguesve vendas dhe atyre të partive për atë KZAZ.<sup>120</sup>

Deri më 16 maj, KQZ-ja kishte numëruar 147,024 (75 për qind) fletë votimi, por 52,368 fletë votimi nga Greqia ishin ndarë veçmas dhe ende nuk ishin numëruar. PD-ja paraqiti disa kërkesa në KQZ për të ndarë mënjane fletët e votimit nga Greqia.<sup>121</sup> Ata pretenduan se kishte pasur një shpërndarje të parregullt të fletëve të votimit nga jashtë vendit (p.sh. një person i vetëm kishte marrë fletë votimi në emër të disa zgjedhësve) ose mosdorëzim të fletëve të votimit.<sup>122</sup> Më 11 maj, KQZ-ja vendosi t'i ndajë mënjane fletët e votimit nga Greqia, por lejoi vazhdimin e numërimit të fletëve të votimit të ardhura nga vende të tjera. Më 12 maj, PS-ja kërkoi zyrtarisht në KAS-i anulimin e kësaj vendimmarrjeje. Më 13 maj, KAS-i e rrëzoi vendimin, duke lejuar përfshirjen e fletëve të votimit në numërim. Më 14 maj, PD-ja e apeloj këtë vendim në Kolegjin Zgjedhor, duke kërkuar rikthimin e vendimit fillestar, por ankimi u rrëzua. Më 16 maj, KQZ-ja miratoi vendimin përfundimtar për të lejuar numërimin e fletëve të votimit nga Greqia. Të nesërmen, numërimi rifilloi dhe përfundoi më 21 maj. Nga 202,187 fletë votimi nga jashtë vendit të marra nga KQZ-ja, 1,973 fletëvotime (1 për qind) u vlerësuan të pavlefshme.

Sipas ligjit, rezultatet e votimit për të dy listat duhet të mblidhen brenda 48 orëve nga mbërritja e materialeve në KZAZ. Asnjë KZAZ nuk e respektoi këtë afat. Sipas rezultateve paraprake, gjithsej u

<sup>119</sup> Numërimi u vonua në Durrës, Tiranë dhe Vlorë. U raportua mbipopullim në qendrat e numërimit në Lezhë dhe Durrës. Durrësi dhe Vlora raportuan mungesë të stafit të numërimit.

<sup>120</sup> Në KZAZ nr. 43 në Tiranë, numërimi u pezullua për disa orë për shkak të një konflikti ndërmjet një vëzhguesi të PS-së dhe sekretarit të KZAZ-së. Shih [vendimin](#) nr. 1112 të Komisionerit, datë 11 maj 2025.

<sup>121</sup> Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore” paraqiti disa kërkesa në KQZ për ndarjen e zarfeve të marra nga Greqia: 1) Më 8 maj, me protokoll nr. 4026, “Kërkesë për ndarjen mënjane të të gjithë zarfeve të Diasporës të marra nga Greqia”; 2) më 9 maj, me protokoll nr. 4137, “Kërkesë urgjente në lidhje me zarfe të fletëve të votimit të marra jashtë procedurës ligjore nga diaspora në KQZ”; 3) më 10 maj, me protokoll nr. 4208, “Kërkesë urgjente për marrjen e masave lidhur me numrin masiv të fletëve të votimit të marra nga Greqia dhe atyre të administruara në KQZ nga persona të paautorizuar me ligj”; dhe 4) më 11 maj, me protokoll nr. 4292, “Kërkesë e përsëritur për ndarjen e zarfeve zgjedhore të ardhur nga Greqia.”

<sup>122</sup> Kontrata e KQZ-së me DHL-në parashikoi se fletët e votimit duhet t'i dorëzohen zgjedhësit individualisht.

hodhën 1,665,501 fletë votimi, nga të cilat 1,607,593 (96.52 për qind) ishin të vlefshme dhe 57,530 (3.45 për qind) të pavlefshme.<sup>123</sup>

Pas zgjedhjeve, situata vazhdoi të ishte e qetë. Para publikimit të rezultateve përfundimtare, Kryeministri Edi Rama shpalli fitoren më 14 maj, bazuar në rezultatet e qarta paraprake. PD-ja organizoi një protestë kundër zgjedhjeve më 16 maj, duke pretenduar se procesi kishte qenë me probleme, dhe më 20 maj kërkoi nga KQZ-ja të mos certifikonte rezultatet zgjedhore deri sa të kryhej një auditim i plotë dhe i pavarur i procesit të votimit nga jashtë vendit, duke cituar shkelje procedurale. Disa drejtues të partive më të vogla kritikuan sistemin zgjedhor si kufizues për aftësinë e tyre për të siguruar mandate në përpjesëtim me numrin e votave të marra.<sup>124</sup>

KQZ-ja publikoi rezultatet paraprake në faqen e saj të internetit sipas qarkut, bashkisë, njësisë administrative dhe QV-së. Megjithatë, u afishuan vetëm rezultatet sipas qarkut dhe bashkisë. Rezultatet paraprake për listat e mbyllura brenda vendit filluan të publikoheshin më 12 maj dhe përfunduan më 18 maj.

KQZ-ja finalizoi proceset e numërimit dhe tabulimit në të 12 qarqet më 26 maj. Menjëherë pas kësaj, disa subjekte zgjedhore paraqitën ankesa zyrtare në lidhje me saktësinë dhe integritetin e procedurave të numërimit të votave në disa qarqe. Në përgjigje të këtyre ankesave, KAS-i, i mbështetur në disa raste nga vendimet e Kolegjit Zgjedhor, urdhëroi rinumërim të plotë ose të pjesshëm të fletëve të votimit në qarqet Tiranë, Dibër, Durrës dhe Fier. KQZ-ja filloi rinumërimin më 17 qershor.

Në qarkun e Tiranës u urdhërua një rinumërim i plotë në të gjitha 18 KZAZ-të. Megjithëse u identifikuan disa mospërputhje në totalin e votave – si mes kandidatëve të së njëjtës parti, ashtu edhe ndërmjet subjekteve të ndryshme zgjedhore – këto ndryshime rezultuan të pamjaftueshme për të ndikuar në shpërndarjen e mandateve parlamentare.<sup>125</sup> Rinumërimet të pjesshme u urdhëruan në qarqet Dibër, Durrës dhe Fier. Në Dibër, një rinumërim i pjesshëm, i kryer pas një ankese të koalicionit “Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë e Madhe”, solli korrigjime të vogla numerike në totalet e kandidatëve individualë.<sup>126</sup> Në Durrës, një rinumërim i pjesshëm dhe një inspektim i materialeve zgjedhore u ndërmorën pas disa ankesave. Gjithsej, u ekzaminuan 174 kuti votimi, duke zbuluar një sërë parregullsish procedurale.<sup>127</sup> Në Fier, u realizua një rinumërim dhe inspektim i pjesshëm pas një ankese nga koalicioni “Nisma Shqipëria Bëhet”.<sup>128</sup> Më e rëndësishmja, rinumërimi çoi në një ndryshim midis kandidatëve brenda listës së PS-së: kandidatja Maldrita Bardho fillimisht fitoi një mandat me një diferencë prej dhjetë votash, duke zëvendësuar Zegjine Çaushin. Megjithatë, më pas Bardho u tërhoq, duke rikthyer në mënyrë efektive mandatin e Çaushit. Përveç kësaj, Komisioni nisi procedura verifikimi

<sup>123</sup> Gjithsej 781 fletë votimi u kontestuan, prej të cilave 762 brenda vendit dhe 19 vota nga jashtë.

<sup>124</sup> Për shembull, bazuar në rezultatet paraprake, Lëvizja “Bashkë” mori 1.5 për qind të votave dhe 0.7 për qind të mandateve, krahasuar me Koalicionin “Shqipëria Bëhet”, i cili mori gjithashtu 0.7 për qind të mandateve, por 4 për qind të votave. Partia “Mundësia” mori 1.4 për qind të mandateve nga 3 për qind e votave, ndërsa PSD-ja siguroi po 3 për qind të votave por vetëm 2 për qind të mandateve.

<sup>125</sup> Një rinumërim nëntë-ditor i 1,207 kutive të votimit në qarkun Tiranë nxori në pah gabime teknike dhe korrigjime të votave, përfshirë humbjen e 612 votave për PD-në dhe 381 votave për PS-në, ndërsa 1,041 fletë votimi u shpallën të pavlefshme.

<sup>126</sup> Korrigjimi kryesor ishte zbritja e 49 votave për Përparim Spahiun dhe shtimi i 17 votave për Xhemal Gjunksin. Megjithatë, këto ndryshime nuk e ndryshuan shpërndarjen e përgjithshme të mandateve, dhe si KSHZ-ja, ashtu edhe Kolegji Zgjedhor rrezuan ankesat e mëtejshme.

<sup>127</sup> Këtu përfshiheshin parregullsi si ngatërimi i vulave të sigurisë, mangësi në dokumentacionin shoqërues, mospërputhje në numrin e fletëve të papërdorura të votimit dhe fletë votimi me shenja identifikuese të qendrave jopërkatese të votimit.

<sup>128</sup> Inspektimi i kutive të votimit dhe materialeve përkatëse nxori mospërputhje në dokumentacionin e fletëve të votimit, përfshirë praninë e fletëve nga një qendër votimi në një kuti të një qendre tjetër, si edhe mospërputhje në numrin e fletëve të papërdorura krahasuar me të dhënat zyrtare.

për 94 kuti votimi nga KZAZ-të e Gramshit dhe Peqinit (qarku Elbasan), të cilat zbuluan mospërputhje të izoluara, të pamjaftueshme për të ndryshuar rezultatet zgjedhore në këto zona.<sup>129</sup>

Më 28 gusht 2025, Komisioni Rregullator certifikoi rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve parlamentare të 11 majit, duke miratuar shpërndarjen e votave, mandateve dhe listave të kandidatëve për të gjitha zonat zgjedhore. Vendimi u miratua me tre vota pro dhe dy kundër, pas debateve ndërmjet anëtarëve të komisionit dhe përfaqësuesve të partive.

## XVI. REKOMANDIME

Këto rekomandime, të përfshira edhe në tekstin më sipër, paraqiten me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të zhvillimit të zgjedhjeve në Shqipëri dhe për të mbështetur përpjekjet për t'i bërë ato plotësisht në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Këto rekomandime duhen lexuar së bashku me rekomandimet e mëparshme ende të pazbatuara të ODIHR-it. ODIHR-i mbetet i gatshëm të ndihmojë autoritetet e Shqipërisë për të përmirësuar më tej procesin zgjedhor dhe për të trajtuar rekomandimet e përfshira në këtë raport dhe raportet e tij të mëparshme.<sup>130</sup>

### A. REKOMANDIMET PRIORITARE

1. Për të adresuar rekomandimet e pazbatuara të ODIHR-it, si edhe paqartësitë dhe mospërputhjet e ndryshme, kuadri ligjor zgjedhor duhet të reformohet në mënyrë gjithëpërfshirëse përmes një procesi konsultues dhe gjithëpërfshirës, që përpara zgjedhjeve të ardhshme, në përputhje me standardet dhe praktikatat e mira ndërkombëtare.
2. Për të siguruar stabilitetin e administratës zgjedhore, duhet të shihet mundësia e depolitizimit të procedurës së emërimit të administratës zgjedhore të niveleve më të ulëta dhe kufizimi i zëvendësimeve arbitrare të anëtarëve të komisioneve në momentet e fundit, për të garantuar trajnimin në kohë dhe si duhet për të gjithë anëtarët.
3. Për të forcuar kapacitetin dhe profesionalizmin e Grupeve të Numërimit të Votave, KQZ-ja duhet të zhvillojë sesione të posaçme trajnimi mbi procedurat e numërimit dhe të hartojë një program të standardizuar trajnimi, duke përfshirë manuale dhe fletë informuese të kuptueshme për procesin e numërimit.

<sup>129</sup> Këto përfshinin afërsisht 15 fletë me një vulë të vetme ose pa vulë fare, diferenca të vogla prej 1–2 fletësh midis numrit të votave të hedhura dhe numrit të zgjedhësve, si edhe mospërputhje midis numrit të fletëve të papërdorura dhe të dhënave zyrtare.

<sup>130</sup> Në paragrafin 25 të [Dokumentit të Stambollit të OSBE-së të vitit 1999](#), Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së u angazhuan “të ndjekin me shpejtësi vlerësimet dhe rekomandimet zgjedhore të ODIHR-it”. Zbatimi i rekomandimeve të mëparshme vlerësohet nga Misioni i ODIHR-it si vijon: rekomandimet 5 dhe 20 nga [raporti përfundimtar mbi zgjedhjet vendore të vitit 2019](#), 6, 8, 12, 13, 15 dhe 23 nga [raporti përfundimtar për zgjedhjet parlamentare të vitit 2021](#) dhe 15, 25 dhe 27 nga [raporti përfundimtar për zgjedhjet vendore të vitit 2023](#) janë zbatuar plotësisht. Rekomandimet 6 dhe 8 nga raporti përfundimtar për zgjedhjet vendore të vitit 2019, 7, 9 dhe 21 nga raporti përfundimtar për zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 dhe 9, 11 dhe 24 nga raporti përfundimtar për zgjedhjet vendore të vitit 2023 janë kryesisht të zbatuara. Rekomandimet 1–4, 7, 12, 13 dhe 18 nga raporti përfundimtar për zgjedhjet vendore të vitit 2019, 1–3, 10 dhe 16 nga raporti përfundimtar për zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 dhe 1–4, 10, 12, 13, 16, 20 dhe 26 nga raporti përfundimtar për zgjedhjet vendore të vitit 2023 janë pjesërisht të zbatuara. Shih gjithashtu [bazën e të dhënave të rekomandimeve zgjedhore të ODIHR-it](#).

4. Përpyekjet për edukimin e zgjedhësve mbi votimin elektronik duhet të intensifikohen për të rritur ndërgjegjësimin e zgjedhësve mbi procedurat dhe për t'u siguruar që të gjithë zgjedhësit të jenë në gjendje të votojnë në mënyrë të pavarur.
5. Për të hequr çdo paqartësi në legjislacion lidhur me fushatën, përdorimi i burimeve administrative për qëllime zgjedhore duhet të ndalohej që nga momenti i shpalljes së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve.
6. Për të garantuar kushte të barabarta gare, autoritetet duhet të marrin masa për të parandaluar keqpërdorimin e funksionit publik dhe të burimeve shtetërore. Duhet të vendosen sanksione proporcionale dhe dekurajuese në mënyrë të shpejtë ndaj shkeljeve të tilla.
7. Në përputhje me praktikën e mira, ligji duhet të përcaktojë qartë se cilat aktivitete parazgjedhore përbëjnë shpenzime fushate, duke u siguruar që ato t'i nënshtrohen raportimit të duhur, mbikëqyrjes dhe sanksioneve të mundshme.
8. Pamjet e përgatitura nga partitë politike ose autoritetet qeveritare duhet të identifikohen si reklamë politike dhe për këtë arsye të ndalohen në lajme dhe në programe të tjera editoriale. Duhet të ketë masa efektive për të adresuar shkeljet dhe këto masa duhet të zbatohen në kohë.

## **B. REKOMANDIME TË TJERA**

### **Administrata Zgjedhore**

9. Për të forcuar kapacitetin dhe profesionalizmin e komisioneve zgjedhore të niveleve më të ulëta, KQZ-ja duhet të hartojë një program trajnimi kaskadë të standardizuar, duke përfshirë manuale dhe fletë informuese të lehta për t'u kuptuar.
10. Kur përcaktojnë vendndodhjen e qendrave të votimit, autoritetet zgjedhore dhe bashkitë duhet të marrin masa proaktive për të siguruar aksesueshmëri në hyrje dhe në brendësi të qendrave të votimit për personat me aftësi të kufizuara.
11. Për të siguruar një pjesëmarrje më të madhe të grave, KQZ-ja duhet të garantojë që komisionet zgjedhore të niveleve më të ulëta të kenë balancë gjinore, duke përfshirë edhe emërimin e grave në pozita drejtuese.

### **Përdorimi i teknologjisë në zgjedhje**

12. Për të garantuar integritetin dhe për të rritur besimin e publikut, vendimet që lidhen me përdorimin e teknologjisë në zgjedhje duhet t'i përmbahen kuadrit rregullator ekzistues dhe nuk duhet të merren si përgjigje ndaj presionit politik.
13. Nëse në të ardhmen shihet mundësia e përdorimit më të gjerë të votimit elektronik, atëherë përdorimi i teknologjive të votimit duhet të menaxhohet në mënyrë gjithëpërfshirëse, transparente dhe të integruar.

### **Regjistrimi i zgjedhësve**

14. Për të qenë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për të garantuar të drejtën universale të votës dhe trajtimin e barabartë para ligjit, të gjitha kufizimet e të drejtës së votës për shkak

të aftësive të kufizuara intelektuale ose psikosociale duhet të hiqen, përfshirë kufizimet e bazuara në vlerësime individuale nga gjykata.

### Fushata zgjedhore

15. Pas konsultimeve gjithëpërfshirëse me palët e interesuara, aktivitetet e fushatës dhe reklamato politike në rrjetet sociale, përfshirë financimin e tyre, duhet të rregullohen duke respektuar të drejtën e lirisë së shprehjes.
16. Për të ndihmuar në mbrojtjen e shprehjes së lirë të vullnetit të zgjedhësve, organet e rendit duhet të bëjnë çdo përpjekje për të identifikuar dhe hetuar të gjitha pretendimet për shkelje zgjedhore, në mënyrë të plotë, të shpejtë dhe transparente. Zgjedhësit duhet të informohen sistematikisht mbi mekanizmat e zbatueshëm për raportimin e shkeljeve, përfshirë mbrojtjen për sinjalizuesit dhe garancitë kundër pasojave negative.
17. Për të rritur pjesëmarrjen politike të grave, financimi publik mund të lidhet me masa konkrete për gjithëpërfshirje. Partitë politike duhet të shohin mundësinë e ndërmarrjes së hapave për reformimin e mekanizmave të brendshëm partiakë për të rritur përfaqësimin e grave brenda strukturave partiake, përfshirë qasjen në fonde.

### Financimi i fushatës

18. Për të garantuar kushte të barabarta gare, kuadri ligjor duhet të parashikojë një tavan të arsyeshëm edhe për shpenzimet e fushatës për kandidatët që garojnë në listat e partive ose të koalicioneve.
19. Për të rritur transparencën, autoritetet duhet të shohin mundësinë e rregullimit të fushatave online dhe nga palë të treta, si dhe të përcaktojnë kriteret përkatëse për fushatat nga palë të treta dhe mekanizmat adekuatë të raportimit dhe sanksionimit.
20. Për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien, KQZ-ja duhet të pajiset me burime shtesë financiare dhe njerëzore, si edhe me një mandat të zgjeruar, që të mundësojë auditim kuptimplotë të raporteve të financimit të fushatës, përfshirë kompetencën për të hetuar burimet e donacioneve.

### Media

21. Autoritetet shtetërore, për të përmbushur detyrimet e tyre pozitive sipas së drejtës ndërkombëtare, duhet të promovojnë një mjedis mediatik të pavarur dhe të larmishëm, të lirë nga ndikimi politik dhe ai korporativ. Duhet të miratohet një rregullim gjithëpërfshirës i pronësisë së mediave dhe të garantohet zbatimi i tij efektiv. Për më tepër, duhet të ndërmerren masa për të mbrojtur autonominë editoriale nga ndikimet e interesave të biznesit dhe politikës.
22. Ndryshimet legjislative duhet të garantojnë depolitizimin efektiv dhe pavarësinë e mirëfilltë institucionale si të Radiotelevizionit Publik, ashtu edhe të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare. Këto ndryshime duhet të përfshijnë konsultime të gjera publike me median e pavarur dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile.
23. Shpifja duhet të dekriminalizohet plotësisht dhe dispozitat civile për shpifjen të harmonizohen me standardet ndërkombëtare për lirinë e shprehjes.

24. Rregullat në Kodin Zgjedhor për shpërndarjen e kohës televizive në mbulimin editorial duhet të ndryshohen për të reduktuar avantazhin e dhënë partive më të mëdha parlamentare dhe për të siguruar një shpërndarje më të drejtë të kohës televizive për të gjithë garuesit.

#### **Dita e zgjedhjeve**

25. KQZ-ja duhet të marrë masa për të parandaluar intimidimin dhe ndikimin e padrejtë mbi votuesit në qendrat e votimit, duke forcuar trajnimin dhe mandatin e koordinatorëve të sigurisë së qendrave të votimit, për të siguruar që ata të jenë politikisht të pavarur dhe të fuqizuar të veprojnë në mënyrë efektive ditën e zgjedhjeve.

**SHTOJCA I: REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË ZGJEDHJEVE<sup>131</sup>**

Subjekti zgjedhor	Vota brenda vendit	Votimi jashtë vendit	Gjithsej	Përqindja	Mandate
Partia Demokratike - Aleanca për Shqipërinë Madhështore	482 279	47 075	529 354	32,93	50
Lëvizja Bashkë	20 270	4 346	24 616	1,53	1
Lëvizja Atdheu	1 989	266	2 255	0,14	0
Partia Koalicioni Euroatlantik	19 562	1 301	20 863	1,30	0
Partia Socialiste e Shqipërisë	733 922	122 255	856 177	53,27	83
Nisma Shqipëria Bëhet	49 464	14 800	64 264	4,00	1
Partia Aleanca Kombëtare Shqiptare	2 722	1 065	3 787	0,24	0
Partia Aleanca Demokracia e Re	1 035	92	1 127	0,07	0
Koalicioni Djathtas për Zhvillim	5 527	492	6 019	0,37	0
Partia Mundësia	43 070	5 925	48 995	3,05	2
Partia Socialdemokrate	47 561	2,329	49,890	3.10	3

	Votimi brenda vendit	Votimi jashtë vendit	Gjithsej
Numri i përgjithshëm i zgjedhësve në listën e zgjedhësve	3,467,962	245,935	3,713,897
Numri i përgjithshëm i grave në listën e zgjedhësve	1 736 183	102 558	1 838 741
Numri i përgjithshëm i zgjedhësve që votuan	1 463 314	202,187	1,665,501
Numri i votave të pavlefshme	55 557	1,973	57,530
Numri i votave të vlefshme	1 407 647	199 946	1,607,593

<sup>131</sup> Rezultatet paraprake nga [faqja e internetit e KOZ-së](#).

## SHTOJCA II: LISTA E VËZHguesve në Misionin Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve

### Asambleja Parlamentare e OSBE-së

Farah	Karimi	Koordinatorë e Posaçme	Holandë
Björn Olof	Söder	Shef i Delegacionit, Deputet	Suedi
Sargis	Khandanyan	Deputet	Armeni
Axel	Kassegger	Deputet	Austri
Christine	Schwarz-Fuchs	Deputet	Austri
Christian	Fischer	Deputet	Austri
David	Stögmüller	Deputet	Austri
Annick	Lambrecht	Deputet	Belgjikë
Franky	Demon	Deputet	Belgjikë
Albin	Muslić	Deputet	Bosnje-Hercegovinë
Teo	Rogić	Stafi i Delegacionit	Bosnje-Hercegovinë
Kyriakos	Hadjiyianni	Deputet	Qipro
Jan	Richter	Deputet	Republika Çeke
Jana	Pastuchová	Deputet	Republika Çeke
Kateřina	Košáriková	Stafi i Delegacionit	Republika Çeke
Lucie	Potůčková	Deputet	Republika Çeke
Silvia	Andrisová	Stafi i Delegacionit	Republika Çeke
Zbyněk	Linhart	Deputet	Republika Çeke
Jens	Meilvang	Deputet	Danimarka
Kalina	Filipovska	Sekretariati i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së	Danimarka
Malte	Möller- Christensen	Stafi i Delegacionit	Danimarkë
Søren	Søndergaard	Deputet	Danimarka
Heljo	Pikhof	Deputet	Estoni
Kersti	Sarapuu	Deputet	Estoni
Mika	Lintilä	Deputet	Finlandë
Ville	Skinnari	Deputet	Finlandë
Andreas	Nothelle	Sekretariati i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së	Gjermani
Stefan	Keuter	Deputet	Gjermani
Christos	Giannoulis	Deputet	Greqi
Eleni Maria	Apostolaki	Deputet	Greqi
Evangelos	Syrgos	Deputet	Greqi
Georgios	Champouris	Stafi i Delegacionit	Greqi
Maria	Antoniou	Deputet	Greqi
Theodoros	Karaoglou	Deputet	Greqi
Arna Lára	Jónsdóttir	Deputet	Islandë
Anna	Bilotti	Deputet	Itali
Catia	Polidori	Deputet	Itali
Eugenio	Zoffili	Deputet	Itali
Fabrizio	Comba	Deputet	Itali
Federica	Onori	Deputet	Itali

Mauro	Del Barba	Deputet	Itali
Maria Luce	Napoliello	Sekretariati i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së	Itali
Pia	Califano	Stafi i Delegacionit	Itali
Roberto	Montella	Sekretariati i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së	Itali
Valeria	Galardini	Stafi i Delegacionit	Itali
Skaidrite	Abrama	Deputet	Letonia
Igors	Aizstrauts	Stafi i Delegacionit	Letonia
Claude	Haagen	Deputet	Luksemburg
Gusty	Graas	Deputet	Luksemburg
Pia	Bisenius	Stafi i Delegacionit	Luksemburg
Alexander	Muscat	Deputet	Maltë
Geert	Gabriels	Deputet	Holandë
Monique	Christiaanse	Stafi i Delegacionit	Holandë
Halil	Snopche	Deputet	Maqedonia e Veriut
Monika	Zajkova	Deputet	Maqedonia e Veriut
Nikola	Micevski	Deputet	Maqedonia e Veriut
Jan Tore	Sanner	Deputet	Norvegji
Sverre	Myrli	Deputet	Norvegji
Barbara	Bartuś	Deputet	Poloni
Kararzyna	Ueberhan	Deputet	Poloni
Marcin	Mykietyński	Stafi i Delegacionit	Poloni
Paweł	Zalewski	Deputet	Poloni
Radosław	Fogiel	Deputet	Poloni
Răzvan-Iulian	Ciortea	Deputet	Rumani
Robert-Marius	Cazanciuc	Deputet	Rumani
Ștefan-Iulian	Lőrincz	Deputet	Rumani
Teodora	Mitru	Stafi i Delegacionit	Rumani
Anzhelika	Ivanishcheva	Sekretariati i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së	Federata Ruse
Daria	Boyarskaya	Sekretariati i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së	Federata Ruse
Michele	Muratori	Deputet	San Marino
Milan	Radin	Deputet	Serbi
Sherif	Abdili	Sekretariati i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së	Serbi
Lucija	Tacer	Deputet	Slloveni
Artemi	Rallo	Deputet	Spanjë
Carina	Ödebrink	Deputet	Suedi
Fredrik	Svensson	Stafi i Delegacionit	Suedi
Joar	Forssell	Deputet	Suedi
Johan	Büser	Deputet	Suedi
Linnéa	Wickman	Deputet	Suedi
Louise	Thunstrom	Deputet	Suedi
Markus	Wiechel	Deputet	Suedi
Matheus	Enholm	Deputet	Suedi
Kemal	Çelik	Deputet	Turqi
Özgül	Saki	Deputet	Turqi

Tekin	Bingöl	Deputet	Turqi
Ecem	Danik Gokce	Stafi i Delegacionit	Turqi
Artur	Gerasymov	Deputet	Ukrainë
Danylo	Zharov	Stafi i Delegacionit	Ukrainë
Iryna	Gerashchenko	Deputet	Ukrainë
Iryna	Sabashuk	Sekretariati i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së	Ukrainë
Pavlo	Frolov	Deputet	Ukrainë
Lee Jason	Barron	Deputet	Mbretëria e Bashkuar
Alanna	Margulies	Stafi i Delegacionit	SHBA
Everett	Price	Stafi i Delegacionit	SHBA
Patrick	Hanish	Stafi i Delegacionit	SHBA

### Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës

Simone	Billi	Shef i Delegacionit, Deputet	Itali
Cerni	Escale Cabre	Deputet	Andorra
Branislav	Borenović	Deputet	Bosnje-Hercegovinë
Denitsa	Sacheva	Deputet	Bullgari
Céline	Thiebault- Martinez	Deputet	Francë
Carine	Roller-Kaufman	Sekretariati i Asamblesë Parlamentare të KiE-s	Francë
Francois	Bonneau	Deputet	Francë
Alex	Schäfer	Deputet	Gjermani
Andrej	Hunko	Deputet	Gjermani
Malte	Kaufman	Deputet	Gjermani
Domenico	Vallario	Komisioni i Venecias	Itali
Valentina	Grippio	Deputet	Itali
Rian	Vogels	Deputet	Holandë
Jone	Blikra	Deputet	Norvegji
Linda	Hofstad Helleland	Deputet	Norvegji
Jan Filip	Libicki	Deputet	Poloni
Stepan	Denega	Shoqërues i z. Libicki	Poloni
Bogdan	Torcătoriu	Sekretariati i Asamblesë Parlamentare të KiE-s	Rumani
Ionuț-Marian	Stroe	Stafi i delegacionit	Rumani
Saša	Zagorc	Komisioni i Venecias	Slloveni
Luz	Martinez Seijo	Deputet	Spanjë
Pablo	Hispan	Deputet	Spanjë
Borianna	Åberg	Deputet	Suedi
Dame Karen	Bradley	Deputet	Mbretëria e Bashkuar

### Parlamenti Evropian

Michael	Gahler	Shefi i Delegacionit, Anëtar i Parlamentit Evropian	Gjermani
---------	--------	--	----------

Andreas	Schieder	Eurodeputet	Austri
Igor	Miskulin	Sekretariati i PE-së	Kroaci
Marina	Graser Lasić	Sekretariati i PE-së	Kroaci
Ana	Książczaková	Stafi i Delegacionit	Republika Çeke
Nikola	Bartůšek	Eurodeputet	Republika Çeke
Alberico	Gambino	Eurodeputet	Itali
Carmela	Scire	Stafi i Delegacionit	Itali
Cecilia	Strada	Eurodeputet	Itali
Raffaele	Luise	Sekretariati i PE-së	Itali
Isabel	Wiseler-Lima	Eurodeputet	Luksemburg
Robert	Golanski	Stafi i Delegacionit	Poloni
Loránt	Vincze	Eurodeputet	Rumani

### Ekipi Bazë i MVZ-së së ODIHR-it

Ambasadori Lamberto	Zannier	Shefi i Misionit	Itali
Rishi	Datta		Kanada
Polyna	Lemos		Mbretëria e Bashkuar
Julia	Manchin		Hungari
Smaranda	Sandulescu		Rumani
Mark	Stevens		Mbretëria e Bashkuar
Elma	Sehalic		Gjermani
Kakha	Inaishvili		Gjeorgji
Kamila	Kolinska		Poloni
Goran	Petrov		Kroaci
Ruslan	Ovezdurdyev		Turkmenistan
Michał	Ostańkiewicz		Poloni
Davor	Ćorluka		Bosnje-Hercegovinë
Maria	Telalian		Greqi
Liisa	Past		Estoni
Jacopo	Leone		Itali
Katya	Andrusz		Mbretëria e Bashkuar
Meaghan	Fitzgerald		SHBA
Anders	Eriksson		Suedi
Max	Bader		Holandë
Anna	Papikyan		Armeni
Sasa	Pokrajac		Serbi

### Vëzhguesit Afatgjatë të MVZ-së së ODIHR-it

Niels Henrik Jermiin	Nielsen	Danimarkë
Martin	Brooks	Mbretëria e Bashkuar
Suhail	Ahmad	Irlandë
Madeleine	Cowley	Mbretëria e Bashkuar
Mikko	Niiles	Finlandë
Tarja	Raappana	Finlandë

Mari	Hagen	Norvegji
Thomas Andreas	Hug	Norvegji
Cosmin Dragos	Laza	Rumani
Knut Lennart	Bergknut	Suedi
Stella	Hellier	Mbretëria e Bashkuar
Mario	Barfus	Zvicër
Véronique	Lasserre-Fy	Francë
Jon	Solnes	Islandë
Katia	Raimondo	Itali
Christian Oliver	Hynek	Austri
Gabriella	Ingerstad	Suedi
Andrea	Jakober	Austri
Anne-Cécile	Leyvraz	Zvicër
Martina	Nikodemova	Republika Çeke
Jana	Planavova	Republika Çeke
Vincent	Godbillon	Francë
Dr. Ulrike	Rockmann	Gjermani
Aldo	Tenisci	Itali
Estrid	Brekkan	Islandë
Gerard	Scott	Mbretëria e Bashkuar

#### Vëzhguesit Afatshkurtër të MVZ-së së ODIHR-it

Alisa	Hayrapetyan	Armeni
Sasun	Hovhannisyan	Armeni
Sedanna	Margaryan	Armeni
Verena	Ringler	Austri
Michael	Sailer	Austri
Michaela	Sivich	Austri
Ines	Ullmann	Austri
Terezina	Dajlani	Belgjikë
Jimmy	Los	Belgjikë
Elias	Louz	Belgjikë
Helena	Saelman	Belgjikë
Goran	Mišković	Bosnje-Hercegovinë
Sanja	Sekulic	Bosnje-Hercegovinë
Montgomeri	Bjornson	Kanada
Rita	Boisvenue	Kanada
Barbora	Cardona Ševčíková	Republika Çeke
Julia	Hawlanová	Republika Çeke
Martin	Klepetko	Republika Çeke
Martin	Konhefr	Republika Çeke
Eva	Mazza	Republika Çeke
Pavel	Neuberg	Republika Çeke
Petr	Svepes	Republika Çeke
Finn	Andersen	Danimarka
Hanne	Bergmann	Danimarka
Grethe	Bille	Danimarka

Peter	Brasholt	Danimarka
Rosangela	de Jesus das Neves	Danimarka
Jorgen	Hoxer	Danimarka
Henrik	Larsen	Danimarka
Kirsten	Lind	Danimarka
Rina	Simonsen	Danimarka
Ott	Laido	Estoni
Liisa	Past	Estoni
Kerttu	Auvinen	Finlandë
Timo	Koisti	Finlandë
Tatu	Oksanen	Finlandë
Anna	Tervahartiala	Finlandë
Jessica	Berthereau	Francë
Laurent	Campigotto	Francë
Sara	Ghobadi Moghaddam	Francë
Mathieu	Lemoine	Francë
Nicole	Osuji	Francë
Geoffroy	Savet	Francë
Stephan	Bauer	Gjermani
Friederike	Behr	Gjermani
Ulf	Claassen	Gjermani
Galina	Diran	Gjermani
Leon	Hemkemeyer	Gjermani
Mirko	Herzner	Gjermani
Patrick	Hoffmann	Gjermani
Christiane	Jaenicke	Gjermani
Anette	Milk	Gjermani
Martin	Ohlsen	Gjermani
Carsten	Schürmann	Gjermani
Frauke	Seebass	Gjermani
Hildegard	Sühling	Gjermani
Andrea	Weber	Gjermani
Johanna	Wolf de Tafur	Gjermani
Nikolaos	Ioannidis	Greqi
Georgios	Lekakis	Greqi
Dimitrios	Nikas	Greqi
Eleftherios	Petropoulos	Greqi
Nicholas	Yiannias	Greqi
Maria	Telalian	Greqi
Aron	Albert	Hungari
Elza	Schönstein	Hungari
Zsolt	Szirmai	Hungari
Gudbergur	Ægisson	Islandë
Sigmar	Gudmundsson	Islandë
Kristín	Hjálmtýsdóttir	Islandë
Karlína	Magnúsdóttir	Islandë
Cillian	Bracken	Irlandë
Maeve	Clayton	Irlandë
Marie	Cross	Irlandë

Nuala	Egan	Irlandë
Michael	Forbes	Irlandë
Andrew	Forde	Irlandë
Cathal	Kelly	Irlandë
Emily	King	Irlandë
Ralph	McGarry	Irlandë
Gwendolen	Morgan	Irlandë
Elizabeth	Mullan	Irlandë
Orla	O'Donnell	Irlandë
Marie	Smith	Irlandë
Lisa	Biondi	Itali
Rosella	Bonarrigo	Itali
Paolo	Carlotto	Itali
Paolo	Fraccaro	Itali
Pietro	Iaia	Itali
Chiara	Parolin	Itali
Jacopo	Leone	Itali
Vladimir	Sacagiu	Moldavia
Dejana	Brkovic	Mali i zi
Ardina	Gerkens	Holandë
Michiel	Irish' Stephenson	Holandë
Sellina	van Bruggen	Holandë
Erik	Verschuur	Holandë
Max	Bader	Holandë
Illir	Islami	Maqedonia e Veriut
Mette	Bakken	Norvegji
Birgitte	Bellsund	Norvegji
Knut	Ditlev-Simonsen	Norvegji
Jonas	Draege	Norvegji
Filipe	Pereira Martins	Portugali
Romulus	Banu	Rumani
Ana-Maria	Popeia	Rumani
Marek	Brenčić	Slllovakia
Samo	Rus	Slloveni
Aleška	Sovinc	Slloveni
Miguel	Aznar Nieto	Spanjë
Lucia	Ferreiro Prado	Spanjë
Elena	García Cabrera	Spanjë
Carlos	Garcia Juarez	Spanjë
Tomás	Mena García	Spanjë
Atria	Mier Hernandez	Spanjë
Alejandro	Moran Rodriguez	Spanjë
Miguel	Pastor Moreno	Spanjë
María	Romero Pardo	Spanjë
Alba	Romero Requejo	Spanjë
Bengt	Ahlqvist	Suedi
Maj	Aigrot Ramsay	Suedi
Jan	Aule	Suedi
Alessandro	Bartolini	Suedi

Linus	Brohult	Suedi
Ann	Brunnberg	Suedi
Anna	Busch	Suedi
Carl	Ek	Suedi
Sanna	Eliasson	Suedi
Linda	Fleetwood	Suedi
Jenny	Gustafsson	Suedi
Alexandra	Hallqvist	Suedi
Carolina	Hamma	Suedi
Lena	Hansson	Suedi
Ami	Hedenborg	Suedi
Carl	Herber	Suedi
Lena	Ingelstam	Suedi
Sara	Isman	Suedi
Kari	Isomaa	Suedi
Marie	Jonsson	Suedi
Anders	Karlsson	Suedi
Karl	Kodeda	Suedi
Björn	Kullander	Suedi
Annika	Leissner	Suedi
Karl	Lindberg	Suedi
Sara	Mejia Lagergren	Suedi
Edgar	Muelle Luza	Suedi
Sven	Nygren	Suedi
Per	Oesterlund	Suedi
Karin	Olofsson	Suedi
Ulf	Ottosson	Suedi
Ulla-Sirkka	Ottosson	Suedi
Ove	Pettersson	Suedi
Nor	Rossnahan	Suedi
Ana	Sjöström	Suedi
Christina	Svejjer	Suedi
Johan	Tejpar	Suedi
Monika	Titor	Suedi
Eva	Winroth	Suedi
Zajlen	Zabbar	Suedi
Anders	Eriksson	Suedi
Fabio	Baiardi	Zvicër
Raphawl	Berger	Zvicër
Thomas	Holzer	Zvicër
Maja	Hürlimann	Zvicër
Marie	Karlen	Zvicër
Roman	Magri	Zvicër
Xheni	Misteli	Zvicër
Stefan	Ziegler	Zvicër
Halyna	Bakhmatova	Ukrainë
Artem	Bykhalo	Ukrainë
Lynne	Charles	Mbretëria e Bashkuar
Sophie	Donszelmann	Mbretëria e Bashkuar

Robert	Mangham	Mbretëria e Bashkuar
Richard	Simcott	Mbretëria e Bashkuar
Marc	Tilley	Mbretëria e Bashkuar
Katya	Andrusz	Mbretëria e Bashkuar
Jacob	Bailey-Daystar	SHBA
Kevin	Connolly	SHBA
Kevin	Deegan-Krause	SHBA
Jared	DeMarinis	SHBA
Devontae	Freeland	SHBA
Mary-Margaret	Hesse	SHBA
Alka	Kothari	SHBA
Nicholas	La Strada	SHBA
Tristyn	Mitchell	SHBA
Dae Bok	Park	SHBA
Christine	Quirk	SHBA
Sophia	Rodriguez	SHBA
Katerina	Sankow	SHBA
Deborah	Scroggin	SHBA
Genevieve	Shea	SHBA
Jake	Slegers	SHBA
Raymond	Snider	SHBA
Maya	Stefanovic	SHBA
Tanya	Urquieta	SHBA
James	Wellock	SHBA

## RRETH ODIHR-IT

Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së që u vjen në ndihmë Shteteve pjesëmarrëse "për të garantuar respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, për të vepruar si shtet ligjor, për të promovuar parimet e demokracisë dhe (...) për të ndërtuar, forcuar dhe mbrojtur institucionet demokratike, si dhe për të promovuar tolerancën në të gjithë shoqërinë" (Dokumenti i Samitit të Helsinkit, 1992 Ky njihet si dimensionin njerëzor i OSBE-së).

ODIHR-i, me seli në Varshavë (Poloni), u krijua si Zyra për Zgjedhje të Lira në Samitin e Parisit të vitit 1990 dhe e filloi veprimtarinë në maj 1991. Një vit më vonë, emri i Zyrës u ndryshua për të pasqyruar një mandat të zgjeruar që përfshinte edhe të drejtat e njeriut dhe demokratizimin. Sot, ODIHR-i punëson mbi 150 punonjës.

ODIHR-i është agjencia kryesore në Evropë në fushën e vëzhgimit të zgjedhjeve. Çdo vit, ai koordinon dhe organizon vendosjen e mijëra vëzhguesve për të vlerësuar nëse zgjedhjet në rajonin e OSBE-së zhvillohen në përputhje me angazhimet e OSBE-së, detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si edhe me legjislacionin kombëtar. Metodologjia e tij unike ofron një pasqyrë të thelluar të të gjithë procesit zgjedhor. Përmes projekteve të asistencës, ODIHR-i i ndihmon Shtetet pjesëmarrëse të përmirësojnë kuadrin e tyre zgjedhor.

Aktivitetet e Zyrës në fushën e demokratizimit përfshijnë: sundimin e ligjit, mbështetjen legislative, qeverisjen demokratike, migracionin dhe lirinë e lëvizjes, si edhe barazinë gjinore. ODIHR-i zbaton çdo vit një sërë programesh të synuara asistence, me qëllim zhvillimin e strukturave demokratike.

ODIHR-i gjithashtu u ofron ndihmë Shteteve pjesëmarrëse për të përmbushur detyrimet e tyre për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, në përputhje me angazhimet e dimensionit njerëzor të OSBE-së. Kjo arrihet duke punuar me një gamë të gjerë partnerësh për të nxitur bashkëpunimin, për të ndërtuar kapacitete dhe për të ofruar ekspertizë në fusha tematike, përfshirë: të drejtat e njeriut në luftën kundër terrorizmit, forcimin e mbrojtjes së të drejtave të personave të trafikuar, edukimin dhe trajnimin për të drejtat e njeriut, monitorimin dhe raportimin e tyre, si edhe të drejtat e grave dhe sigurinë.

Në fushën e tolerancës dhe mosdiskriminimit, ODIHR-i u ofron mbështetje Shteteve pjesëmarrëse për forcimin e reagimit të tyre ndaj krimeve të urrejtjes dhe incidenteve të racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe formave të tjera të intolerancës. Aktivitetet e ODIHR-it në këtë fushë përqendrohen në: legjislacionin; trajnimin e organeve të rendit; monitorimin, raportimin dhe ndjekjen e reagimeve ndaj krimeve dhe incidenteve të motivuara nga urrejtja; si edhe aktivitete edukative për të promovuar tolerancën, respektin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë.

ODIHR-i ofron këshillim për Shtetet pjesëmarrëse lidhur me politikat e tyre për Romët dhe Sintit. Ai promovon ndërtimin e kapaciteteve dhe rrjetëzimin brenda komuniteteve Rome dhe Sintit, si edhe nxit pjesëmarrjen e përfaqësuesve të këtyre komuniteteve në organet e hartimit të politikave.

Të gjitha aktivitetet e ODIHR-it zhvillohen në bashkërendim dhe bashkëpunim të ngushtë me Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, institucionet dhe misionet e OSBE-së në terren, si edhe me organizata të tjera ndërkombëtare.

Më shumë informacion mund të gjendet në faqen e internetit të ODIHR-it ([www.osce.org/odihr](http://www.osce.org/odihr)).